

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME NAZLIJE BALA

Prishtinë | Data: 21 qershor dhe 3 korrik 2012

Kohëzgjatja: 135 minuta

Të pranishme:

1. Nazlie Bala (E Intervistuar)
2. Anna Di Lellio (Intervistuesja)
3. Fabiola Berdiel (Intervistuesja)
4. Sara Nicole Baxley
5. Zana Rudi (Intervistuesja)
6. Kaltrina Krasniqi (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - e intervista shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtës kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale të japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Fëmijëria

Zana Rudi: Nazlie si e mbani mend fëmijërinë tuaj?

Nazlije Bala: Po, si çdo fëmijëri edhe si çdo fëmijë që ka kujtime, përjetime dhe nostalgji ato janë të shumta tek çdo person që ekziston. Po e di që ka qenë një fëmijëri e bujshme, plot me angazhime, një fëmijëri në të cilën shumë herë e gjej vetvetën kur kthehna në skenë të asaj fëmijërie.

Një fëmijëri që ka përjetu edhe ngjarje të ndryshme edhe ngjarje të gëzimit edhe të hidhërimit, edhe të vajit edhe të lotit edhe të harmonive, do të thotë e larmishme. Por e di që kam qenë një fëmijë jashtëzakonisht dinamik, një fëmijë që është mundu me mbërrë çdo gjë, një fëmijë që është mundu me arritë... do të thotë me prek ndoshta edhe të pamundurën. E di që si fëmijë, do të thotë po e përshkruaj ato prej momenteve të para në shkollë, ndoshta periudhë ma e hershme se shkolla, fëmijë i cili ka qenë i interes në instrumente të muzikës, fëmijë i cili ka qenë i interesum në sporte të ndryshme. Fëmijë i cili ka qenë i interesum do të thotë të depërtoi aty ku imagjinata e fëmijës, çdo herë është në rend të parë, dhe shumicën e kësaj imagjinate edhe e kam përjetu, për arsye se atë çka e kam ëndërru e kam realizu, do të thotë në jetën e përditshme. Dhe nëse kthena dhe e kërkoj edhe një herë fëmijërinë e di që shumë periudha i kam tejkalu, kur të them fëmijë i cili ka lypë çdo instrument muzikor, për tetë vite kam ushtru edhe e kam përdorë, edhe sot e përdori klarinetin që është një karakteristikë. (Buzëqeshë). E dyta, ndoshta një sport i pazakontë për mu ka qenë... përpara se me hy në klasën e parë, m'ka interesu loja e shahut, dhe me kalimin e kohës kam qenë dhe Kampione e shahut në Kosovë për Junior. Si fëmijë, nëse i kemi shiqu filmat e ndryshëm, sidomos filmat e sporteve luftarake... do të thotë kam arritë që ta kem shiritin e kaltërt në karate. Si fëmijë nëse e kam kërku do të thotë lojën e topit poashtu kam lujtë edhe futboll edhe hendboll, përveç basketbollit, sport i cili ka qenë diçka për mu jashtë domenit tim.

Kur i kompletoj të gjitha këto elementet, do të thotë si fëmijë edhe nëpër çka ka kalu imagjinata ime, lirisht mund të them që me një formë, me një mënyrë kam qenë luftarake për atë që e kam imagjinu, për atë që kam ëndërru. Dhe në realitet do të thotë të gjitha këto më kanë sjellë deri te një eksperiencë sikur fëmijë, ndoshta që fëmija e sodit nuk e kanë.

Poashtu si fëmijë një pjesë shumë të madhe të fëmijërisë time e kam kalu edhe në fshat, zakonisht kur kanë ardhë pushimet verore, do të thotë automatikisht e ke pas atë ëndërrën të shkojsh dikun edhe ti kalojsh tre muaj ditë të pushimeve. Në fshat dihet mo jeta, jeta e fshatit se cila është dhe cila ka qenë në atë kohë, edhe pse sot ndryshon. Si fëmijë më ka interesu se si mbjellet misri, gruri, elbi, tërshana dhe si fëmijë më ka interesu se qysh vijnë ato t' mirat, do të thotë që toka na i dhuron. Sot nuk e kom problem edhe me prashit misrin, edhe me korrë grunin, edhe me korrë elbin, tërshanën dhe të gjitha këto, do të thotë është një laramani e një fëmijërie të cilën unë e kam kalu. Ndoshta do ta lidhi me një element tjetër si fëmijë, që për sot është shumë çudi me bisedu. Si fëmijë, kam përjetu edhe grupet e para ilegale në atë kohë që kanë qenë, edhe pse në esencë pa e kuptu se cilën postë unë e barti, çfarë dokumenti unë e kam

me veti, dhe cilat kanë qenë kontaktet e mia në atë kohë. Do të thotë, pa e kuptu në esencë komplet procesin se çka si komb kemi dasht me depërtu. Si fëmijë më kujtohet që shumë herë ma kanë dhonë një dokument, një letër, një çantë, do të thotë “merre këtë çantë, shko dërgoja” për shembull, “po e marr X personin”. Do të thotë përjetimet që ma vonë i kam kuptu, se edhe si fëmijët kanë ditë në atë kohë që një detyrë dhe një përgjegjësi për moshën, mendjen që e ke, me ta dhonë dhe me ekzekutu, po e them në kuptimin e plotë të fjalës atë detyrë.

E mbaj në mend, edhe procesin mrena për mrena familjes tem, familje e cila nana edhe baba e kanë kriju, do të thotë prej asaj harmonie familjare që i kanë pas tetë fëmijë: pesë vllazën dhe tri motra. Unë jom e pesta me radhë, tre vllazën mas meje janë që vijnë dhe m’kujtohet si fëmijë, do të thotë e kam pas atë fuqinë, sidomos prej vëllezërve të cilët janë mas meje, atë fuqinë e udhëheqjes apo atë fuqinë që dikush ka mbështetje te ti, apo atë fuqinë që dikush kërkon përkrahje te ti, apo atë fuqinë që dikush kërkon mbrojtje nga, nga ti. Përveç fushave të cilat i tregova që kanë qenë në imagjinatë dhe që i kam përjetu, do të thotë në një aspekt e kam ndi, e kam ndi atë fuqinë shpirtërore të cilën e kam dhe atë fuqinë fizike e cila ka egzistuar tek unë, sepse, kam qenë edhe një lidere e lagjes, lidere edhe... edhe, e djemve, edhe... edhe e vajzave, do të thotë pa miratimin tem absolutisht nuk ka mujt kërkush me lujtë në lagje, apo pa miratimin tem nuk ka pas të drejtë asnjë fëmijë me ndërmarrë ndonjë aksion për ndonjë lojë të caktuar apo çka po di çka. (Buzëqeshë) Sidomos kohës së dimrit, ku secili fëmijë i gëzohet edhe borës së parë, edhe atij argëtimit me borë dhe me saja e me të gjitha ato... do të thotë nëse unë kam qenë në lagje absolutisht s’ka guxu asnjë fëmijë me u lshu me sajë në lagjen teposhtë nëse unë nuk kom qenë prezente. Jo që unë kom ushtru lloj diktati në ta, po si fëmijë e kom vërejt që nëse ti krijon një grup të caktuar dhe din me menaxhu me atë grupin e caktuar atëherë t’gjithë do të jenë pjesëmarrës të barabartë të asaj loje, apo të asaj kohe të dimrit apo të verës, çfarëdo qoftë. Në atë kohë i kam përjetu edhe ndoshta nëse kam të drejtë me thanë, edhe shkathtësitë e liderizmit se si, si udhëheqet një grup se si udhëheqet një fëmijëri me ata fëmijë, do të thotë të cilët të gjithë kemi pas botën e barabartë apo imagjinatën e barabartë. Si fëmijë kam dit me marrë edhe detyra, edhe përgjegjësi, kam qenë jashtëzakonisht e përgjegjshme për çdo kërkesë, po e them në rend të parë prej familjes që më është bërë, mandej prej rrethit dhe prej lagjes.

Si fëmijë kam mësu se çka është respekti, çka është nderi dhe si fëmijë kam mësu shumë mendime, kam mësu shumë preokupime të njerëzve, si fëmijë kam ndëgju ngjarje të ndryshme, sidomos ngjarje të cilat janë thanë prej nanës. E kur ajo tregojke ngjarjen e persekutimit të familjes personale të sajna, menjëherë mbas Luftës së Dytë Botërore ku komplet familja i është vra, dhe për mua dukej një botë e pakuptimtë se si mundej me u ekzekutu një familje e tanë prej moshës 12 vjeçare e deri tek më i moshumi. Dhe, për mua ka qenë e pakuptimtë për arsye se historia në atë kohë na ka mësu që partizani ka qenë shumë i mirë, partizani ka ushtru luftë çlirimtare, partizani ka qenë me popull përderisa, ka qenë komplet, komplet e kundërta. Ndoshta, fëmijëri ku nuk kom mujt me i kuptu prindët e mi se pse në heshtje çdo herë e kanë tregu këtë ngjarje, dhe si fëmijë do të thotë jo krijimin e urrejtjes, jo krijimin e një nacionalizmi të caktuar në vetvete, po si fëmijë që të kesh informacion që çka ka ndodhë me familjen, me pjesën tjetër të familjes. Ma vonë, do të thotë në zhvillim e sipër si fëmijë dhe si qenie njerëzore në pikë të parë, tek kom fillu me i përjetu ato ndasitë e para, ato shkeljet e para me i përjetu regjimet, si, si regjim në brendi dhe ndoshta kam qenë e pajisur me informacion shumë të plotë. Me informacion do të thotë që në atë kohë kanë vepru grupe të ndryshme, e grupe të cilat janë mundu me shpërnda se çka është regjimi me shpërnda se çka është shkelja e të drejtave të njeriut. Me shpërnda atë informacion se çka do të thotë të jesh i shtypur, se çka do të thotë të jesh rob dhe çka do të thotë që të mungon liria në kuptimin e plotë të fjalës.

Dhe një karakteristikë tjetër për mua që bën shumë përshtypje si fëmijë kur kam fillu klasën e parë, personalisht jam person i majtë, do të thotë anën e majtë e kam të zhvill dhe sot nuk muj me kuptu pse ka qenë gjithë ajo trysni, gjatë tanë periudhës të klasës së parë, kam qenë e shtyme me dhunë {lëviz duart} me shkru me dorën e djathtë dhe element i asajna do të thotë çfarë lloj metode dhe cila është përdorë që mua sot më rrok tmerr kur e kujtoj. Në atë kohë kanë qenë banka klasike, e jo karriga, edhe më merrte dorën e majtë, më lidhte {bën sikur po lidhë dorën me litar} gjatë orëve të mësimi, sa kanë qenë katër orë - pesë orë të mësimi që i kemi zhvill, edhe presioni edhe trysnia për mua ka qenë një lloj dhune psikike me përdorë ndaj një fëmije, që do të thotë sapo kish hy në hapat e parë të shkollës me tentu me shkru me dorën e djathtë. Kështu që, si fëmijë ka shumë ngjarje, ndoshta nuk do të mund me shkoqit atë e cila është më interesante, po për mua nëse dikush më pyet nëse isha kthyer prapë në fëmijëri... besoj që po. Besoj që isha kthyer edhe nihere prapë në atë kohë të fëmijërisë, se a do te kisha përcjellë po të njëjtat gjëra që unë i kam përjet si fëmijë në shumicë them po, ndërsa një pakicë shumë e vogël është jo.

Zana Rudi: Tash po të bëj një pyetje më të gjatë, kisha pas dëshirë të di më shumë për mënyrën e jetesës, për familjen, për prindërit tu, çfarë kanë bërë ata. Ti fole për storiet e nënës tënde, fole për shkollën, për ngjarjet për fshatin ku ke shk gjatë verës...

Nazlije Bala: Nanën e kam pas amvise, ndjesë pastë, ajo nuk është më në mesin tonë, ndërsa babin e kam pas teknik medicinal në atë kohë. Kemi qenë tetë fëmijë, pesë vëllezër dhe tri motra, kemi pasur një jetesë mesatare, ka ndodh herë herë mos me qenë mesatare, po flas për periudhën ku kemi qenë të gjithë një nivel {tregon nivelin me duar}. Ndoshta, shumë here m'u ka dashtë shpejtë e shpejtë me u kthyer prej shkollës, që me liru çantën për t'ia dhënë vëllaut tjetër sepse ai shkonte [në shkollë] në ndërrimin tjetër. Ndoshta ka ndodhë edhe vëllau shpejtë e shpejtë me e kry orarin e shkollës edhe me u kthyer me ja dhënë çantën vëllaut tjetër, kështu që me një çantë kemi shku në shkollë të tre fëmijët brenda një periudhe të caktuar kohore të mësimi.

Si fëmijë, kemi ëndërru shumë, ndoshta gjithë ato lodra nuk kemi pas [mundësi] me i ble. E di më kujtohet me vajza të vogla kur dilshim me lujtë... aty-këtu {lëvizë duart} ka pas vajza të cilat kishin kuklla. Dhe nana... prindërit në pamundësi me ble kukulla, nëna ime merrte një shtagë të cilën e ndante në dy pjesë si lloj kryçi të mbështjellur me lecka {demonstron me duar} dhe ka bërë qepjen e asaj kukulle, dhe kur unë e kam pas atë kukëll në dorë m'u ka dukë që jam në botën e çudirave, ose sikur Liza në botën e çudirave se e kam fitu një kukëll, si shenjë dhe si dhuratë e nanës.

Më kujtohet që i'u kemi gëzu shumë, i'u kemi gëzu shumë festave të ndryshme që kanë qenë e që edhe sot janë, sidomos festave të Bajramit për arsye se kemi veshur petka të reja për arsye se e kemi ditë që prindërit kanë qenë të dedik... jo që nuk kanë qenë tërë kohën të dedikum, por e ke ditë që kanë qenë të dedikum të të blejnë petka të reja për ditën e Bajramit. Më kujtohet si fëmijë që kemi shku derë... është ngjarje shumë interesante si fëmijë, domethënë kemi shku derë me derë për të bërë Bajram, dhe në momentin kur kemi bërë Bajram, në atë kohë kanë qenë banka, nuk e di a i mbani në mend, por kanë qenë do banka të kuqe [monedhë] dhe tash nëpër gjithë lagjën dhe në farefisni që i kemi mbledhur ato banka, si fëmijë çka kemi ba? Edhe pse dihet që dreka e Bajramit është dreka më e begatshme thuhet në çdo familje, por si fëmijë më e shijshme na u ka dukë me shku në ëmbëltoje edhe me ble një bakllavë me një sutlash [tomloriz], edhe me marr atë lëngun e bakllavës edhe me derdh në tomiloriz. Ndërsa në tërë ditën kishim hangër bakllavë dhe tomiloriz në shtëpi, do të thotë bakllava ka qenë shumë e rrallë dhe një herë në vit është përgatitë në shtëpi.

E dyta, si fëmijë më kujtohen dhuratat kur janë dhënë, edhe kur janë dhënë dhuratat atë kohë për vitin e ri, do të thotë çdo familjes i kanë taku dhuratat... prindit i kanë taku. Dhe ne si familje kemi marrur më së shumti dhurata, tetë dhurata, tetë thasë të mëdhenjë, {me duar tregon madhësinë e thesit} edhe tash ajo ngacmimi në mes neve se “jo unë po e çeli dhuratën,” “jo ti s’po e çel dhuratën,” “jo ti ke hangër më shumë,” “jo unë kam hangër më shumë.” E më interesant... sot Coka Cola pihet si pije normale e është kudo dhe është përditshmëri në tryezat tona, e në atë kohë nuk ka pas. Do të thotë e ke pi Coka Cola-n një herë në vit, vetëm kur ka qenë Viti i Ri, Jupi [markë e pijes] ose Pepsi, Jupi tash nuk ka më nuk ekzistojnë, ndërsa Coka Cola-n e kemi pasë një herë në vit në sofrën tonë.

Karakteristikë për përjetimet e fëmijënisë, meqenëse si familje kemi qenë të vetmit në Prishtinë, ndërsa farefisi i gjerë, jo i ngushtë, ka qenë në fshatra. Kjo ka ndodhë pothuajse te çdo familje, kuptohet fëmija si të kthehet në shtëpi fjalën e parë e ka, “bukë,” (buzëqeshë) me lyp bukë dhe tash kur ne fillojshim me ardhë prej mësimi unë dhe tre vëllezërit e mi, elementi i parë, fjala e parë, kontakti i parë me nënën ka qenë “me çka me ngrënë do bukë?” Dhe sot te na është një fjalë e cila përdoret shumë shpesh, që na e përkujton atë kohë dhe përgjegjja e saj ka qenë “me dhëmbë.” (Qeshin) Dhe ti faktikisht s’ke qare pa e kafshu me dhëmbë për me e përtyp, ska dhënë asnjë herë informacion se çfarë ka përgatitë për drekë. Ndoshta e ka përgatitë drekën, mirëpo ndërkohë ka pasur mysafirë dhe për respektin ndaj mysafirëve ajo drekë është shtrur për ta, por ti si fëmijë nuk e ke pasë qasjen në atë drekë për respektin e madh që kanë pasë ndaj mysafirëve. Edhe një element shumë interesant, sot domatet, specat i gjen pothuajse në çdo sezonë dhe ekzistojnë në çdo sezon, në atë kohë ke pasë vetëm në periudhat e para të verës. E kur pjekeshin specat në atë kohë, era i vinte shumë larg dhe se ti kur je kthyer prej shkollës e ke ndi erën e specit shumë shumë larg. Aq shumë ka pasë bujë në atë kohë, dhe kur ke hy brenda ke pa mysafirë, mirëpo ti si fëmijë dhe ndaj respektit je ulë në një qosh, asnjëherë me u ul e barabartë në bukë me mysafirë. Je ulë në një qosh dhe ti tan kohën e ke përcjellë mysafirin se qysh po e han një spec, do të thotë ajo lakmia “po të isha unë në vend të tij.” Dhe, atëherë nuk ka pas tanira [pjata] tash qysh shtrohet tryeza secili ka pjatën e vet, kanë qenë dy - tri pjata ku komplet familja ka hangër aty, tash dhe mënyra e të ngrënit të specit, shikëputjes së specit prej me kapjen e pjesës kryesore të tij me kokë lartë dhe metshe me sy kah mysafiri, jo se e shikojshe mysafirin me mënyrën e të ngrënit por nga lakmia pse s’jom unë me ngrënë atë spec ose atë domate ose një e mirë që është sjellë. Karakteristikë tjetër, po flas gjithmonë për mesin familjar, ka ekzistuar një respekt jashtëzakonisht i madh.

Poashtu një element tjetër për shkak që kemi qenë fëmijë shumë në familje, dhe në pamundësi që të gjithëve të na blejnë petka ose ti përmbushë kërkesat tona, atëherë baba dy herë në vjet... Do të thotë kredinat kanë qenë shumë aktuale në atë kohë, me një përqindje shumë të vogël sidomos në periudhën e dimrit me na ble tesha, jakne, pallta në kohën e dimrit. Si fëmijë nuk ke mendu që pallton duhet me veshë edhe dimrin tjetër, ti e ke mendu që atë pallto duhet me veshë vetëm atë vit edhe vitin tjetër duhet me ble një të re. Dhe kur na dërgojke prindi në shitore, ku ka qenë shitorja e Varteksit afër Shtëpisë së Mallrave sot ku është administrata, Ministria e Transportit afër libarisë ka qenë aty, na shtike baba në dyqan me i provu jaknet. Edhe ashtu e vogël kom qenë me trup. Prindi çdo herë ka mendu edhe për vitin e ardhshëm me siguru veshmbathjen për fëmijë, ndërsa na si fëmijë kemi mendu gjithmonë aty për aty. Dhe, kur ishim në dyqan me i provu jaknet dhe mëngët vishin deri këtu {tregon te duart gjatësinë e mëngës} e binin të mëdhaja, dhe ne i thoshim “Aga, po jaknja e madhe,” ai thoshte, “Qoj duart lart.” Dhe në momentin kur i qon duart lart ajo faktikisht shkurthet, e ai thoshte “E taman e ki.” Dhe kjo ka qenë thujse e persëritur deri sa kemi arritur një moshë madhore që vërtetë s’kemi pasur nevojë edhe për dy tri vite me i përdorë ato jakne.

Karakteristikë tjetër në fshat, sidomos kur kam kal kohën tek familja e nënës në fshatin Koliq, familje e cila ka qenë e persekut e ekzekut gati të gjithë meshkujt e familjes pas Luftës së Dytë Botërore. Ka qenë një kullë, një kullë grandioze, e madhe, një familje e madhe që ka pas shumë autoritet. Tash, axha i nanës në atë kohë i ka mbledhë bijat që sot nuk është karakteristikë me i mbledhë bijat. Ka qenë kohë e verës, unë për vete kam punu në fushë, që nuk e kam pasë problem por që edhe sot s'e kam problem me punu në fushë. Tash me rrotullu sanën, me rrotullu barin, me ç'vosh kallamoqin, me hek kallamoqin prej boqës, me fshi grunin, do të thotë me nda grunin prej kallamit. Me maru voza, janë ato pjesët e vogla ku teret bari dhe që përdoret si ushqim për bagëti gjatë kohës së dimrit. Në atë kohë nuk ka pasë konop, normal vozat janë pshtjellë me konop me i majt tubë, atëherë konopin e kemi maru prej kashtës. Ai lloj konopi që marohet prej kashtës në formë bisteku thirret lektyrë, do të thotë me maru lektyrë. Tash ti tan ditën ke maru lektyra dhe ty lëkura të ka ra, se kashta është paksa e vrazhdë për duart, mirëpo asnjëherë nuk kemi ndi lodhje. Ose bartja e ujit, nëse ne si fëmijë nuk kemi mujtë me kontribu në aspekte të tjera në atë familje ku unë kam qëndru brenda një periudhe dy muajshe, atëherë e kemi ndi obligim së paku, pasi që uji ka qenë shumë larg dhe nuk ka pasë ujësjellës, por me bunar. Bunari ka qenë afër katër kilometra larg shtëpisë, dhe formën e bartjes së ujit... I merrshim kazanat, ka shkojshim ka qenë shumë lehtë, se ka qenë kazani i zbrazët mirëpo, kur jemi kthy e kemi marrë një dru shumë të gjatë dhe i kemi fut kazanat një nga një në atë drurin, dhe, bartjen e kemi ba me krahë, dy vetë ose tre vetë, varësisht se sa kazana me ujë i kemi pasur. Ose koha e bukës kur ka qenë përveç këtyre elementeve tjera kom shku edhe me bagëti shumë, me i qitë me kullosë me lopë, me dhenë, me bullica. Ose se ka pas axha i nanës, edhe me dele shumë ka pas afër 150 dele. Shumë është interesant delja do të thotë, kur e ka kohën me mjelë, ajo e din renin dhe vetë shkon. Gruja e axhës do të thotë ka qenë ajo e cila kryesisht është marrë me bylmet, me të mirat e tamlit, produktet që i ka nxjerrë. Edhe tash u bojshim rend dy tri veta dhe secila kofen afër për veti, dhe për me kry ma shpejt do të thotë, se bagëtitë veç pritshtin edhe lopët, edhe bullicat, edhe delet, edhe dhitë për me i mjelë. Tash u bojshim rend dy tri vetë, edhe kofen në mes kamëve... dhe shpejt e shpejt me mjelë, do të thotë për me i rahatu bagëtinë, nëpër vende të ndryshme me i'u shtru kashtë, me i'u qit ujë. Rrymë nuk ka pasë në fshat atje, do të thotë, jemi kon me fener dhe derisa ti i ke rregullu krejt këto elemente këto përgjegjësi; do të thotë, të shpisë që kanë qenë është dashtë me i bo krejt para territ, se në momentin kur ka ra terri ka qenë paksa e vështirë me depërtu.

E në mramje, në mramje çka bojshim, nuk ka pas kreveta, nuk ka pas kauça dhe nuk ka pas syngjera. Ka qenë do të thotë pjesa e banimit e shpisë ku na kemi nejt, po mendoj komplet kulla jo vetëm aty, oda ka qenë e veçantë, me thonë ka qenë 20 metra me 10 metra e gjanë. Shkallët i ka pas të veçanta, jo mrena hymjes kryesore të shpisë mirëpo i ka pas shkallët krejt në atë pjesën tjetër të kullës. Edhe tashti do të thotë kemi lujtë lojna të ndryshme, por kemi lujtë me def, o kemi lujtë guralec me pesë gurë, nuk e di a e dini atë lojë guralec me pesë gurë qysh luhet. Do të thotë merren pesë gurë, edhe me të pestit i qon nalt dhe bien të pestit poshtë mirëpo, asnjëherë nuk guxon me sy me i kqyrë gurët. Mirëpo, pa shikim do të thotë shikimi nalt {shikon lartë dhe bën sikur po mbledhë gurët} edhe mledhjen e gurëve dhe këtë metodën e gishtave duhesh me majtë {mban gishtat në mbështetëse dhe ngritë lartë shuplakën e dorës} edhe me këtë tjetrën dorë me të parën herë me i mledhë gurët edhe me guri me depërtu nga kjo ana tjetër {dora e lirë depërton në hapësirën e krijuar nga dora tjetër, shuplaka e të cilës është e ngritur lartë dhe majet e gishtave në tokë}.

Kemi këndu kangë të ndryshme, sidomos kangët e çobanëve, sot i di ato kangë përmesh Edhe si fëmijë është traditë, sot nuk bohet ajo traditë nëpër katune... Me sitë kulaqin, nuk e di a e dini çka është me e sitë kulaqin. Kur të përfundon sezona e kullosave në fushë, do të thotë e bagëtisë, të gjithë ata që kanë qenë çobanë, e kanë për traditë secila shpi organizon drekën; mirëpo, dreka nuk hahet në shpi, por aty ku kanë

qenë kullosat, ku ke dalë ti me bagëti. Një drekë jashtëzakonisht e begatshme, ka pas lojë, ka pas kcim, ka pas kangë edhe neve na thirrshin “Hajde ju fëmija e shehrit.” Do të thotë, ka qenë ajo që e kanë ndi ndasinë në mes fëmijëve të katunit dhe të fëmijëve të qytetit... “Hajde ju fëmija e shehrit.” Do të thotë ka qenë një kënaqësi jashtëzakonisht e madhe, unë për veti me shumicën e atyre njerëzve kam kontakte edhe sot. Një pjesë shumë e madhe e tyre nuk i kanë braktisë asnjëherë katunet ku unë kam ndejtë, edhe do të thotë sa herë takohemi gjithmonë i kemi memoriet.

Një element tjetër ndoshta është pak rrëqethës por është një realitet, në fshat te halla ime ai fshat thirret Keçekollë, është në komunën e Prishtinës... Thirret një mal Dubok e ka emrin, dhe sot e atë ditë në atë mal gjinden armë të Luftës së Dytë Botërore. Pak me hy në thellësi të malit i gjen ato pushkë, granata të dorës e krejt ato, edhe fëmiju si fëmiju depërton gjithkunj edhe hin në çdo skutë, në çdo birë. Edhe rastësisht e gjetëm na një bombë të dorës na si fëmijë, edhe e morëm atë bombë me veti edhe tash dolëm prej malit është rruga e asfaltume që është në kufi me Serbinë që shkon, dhe e kemi marrë atë bombë. Edhe për katër orë t’ana jemi mundu me e eksplodu bombën përpara asfaltit (buzëqeshë)... Merre e mshoj për asfalti, s’ka; merre gjuj gurë në atë bombë e nuk eksplodon, po nuk eksplodon. Edhe hajde po dhezim zjerm edhe pe gjujna në zjerm bombën. Edhe u kan ka ora tetë mramje dhe kemi dhezë zjermin si çobanë, e kemi dhezë zjermin, edhe e kemi qit bombën në mes të zjarrit edhe na krejt rreth sa jemi kon 15 a 20 fëmijë, dhe kemi prit kur po eksplodon bomba, pa e pas atë mendjen që ajo bombë mundet me qenë fatale e ka mujtë me na mytë krejtve aty, edhe nuk eksplodoi. Hajde tash, u kthym secili nëpër shpija, dhe kur kemi hy mrena në odë, se është nejtë nëpër oda atëherë në katun, dhe kemi fillu me hongër bukë... Vendi ku ka qenë ku na kemi nejtë si fëmijë, si me thonë prej kodrës t’ Gërmisë deri në kodrat e Makovcit, qaq largësi, largësi e madhe, edhe t’u honger bukë do të thotë si fëmijë në sofër përnihërë e kemi ndëgju eksplodimin edhe është dridhë. Do të thotë, është dridhë oda, xhamat veç dulen prej venit, dy-tre vene do të thotë jonë thy. Na si fëmijë vetëm jemi kqyr në mes veti edhe e kemi ditë se çka ka ndodhë. Edhe këta të mdhajtit që ishin burri i hallës, djemtë e hallës, kunati i hallës, atëherë kanë qenë në bashkësi familjare. Na kanë thonë “Mos keni bo naj qeder,” naj kader... Naj element negativ do të thotë, edhe na kemi thanë jo. Të nesërmen kur kemi shku me pa venin ku ka eksplodu ajo bombë, ku na kishim nejt me orë të tana rreth atij zjerri për me eksplodu ajo bombë... S’po di me thonë sa komplet kjo ndërtesa që ish bo gropë e madhe. Tash kur e mendojmë e kujtoj atë ngjarje, do të thotë, si fëmijë s’ke ditë me mendu.

Forma e jetesës në katun të cilën unë e kom bo nuk ka pas as kauqa, as kreveta, as sfungjera, as shilte, as absolutisht kurgjo. Ka qenë një pjesë e drunit dhe gjysma e dhomës është nda, është shtru një dru trapazan thirret ai dru, shtrohet dhe mbulohet pjesa tjetër me kashtë. Qitet plafa, jo qebe, jon kon plafa të konopit në atë kohë... plafat përmi dhe jastaka rreth e rreth kashtës, nuk ka pas jastak as të pendlave as të pambukut apo të sfungjerit, vetëm bukalisht jastak i mbushur me kashtë. Dhe kemi nejtë sa kemi nejtë qaty, kemi honger qaty, kemi lujtë, kemi knu, kemi kcy, edhe në momentin “hajde me ra me fjetë” dhe ti vetëm e ke marr atë jastakun e kashtës edhe e ke ngre. Do të thotë sikur kta me marrë edhe me qitë krytë {l referohet jastakut afër saj} edhe je mlu me plafa se ka qenë fukarallëk i madh në atë kohë. S’ka pas jorgana, ose jorgana të krijum prej teshave të ndryshme çka kanë mujtë me gjetë tesha që s’jon përdorë mirëpo që i kanë marrë i kanë kepë dhe kanë kriju jorgan.

Forma qysh e kemi ndreqë venin është shumë interesant, jemi qu n’mengjes, ata jorgana i kemi marrë i kemi palu, edhe hjekën plafat prej kashtës; duhesh me marrë drapërin, me majen e drapërit me e qu kashtën nalt, se ajo tan kohën tan natën... do të thotë ti e ke kriju atë palimin e ke palu, e ke paketu kashtën, do të thotë ka ra nën nivelin e trapazanit i cili e ka nda pjesën e nejtës me pjesën ku ti ke lëvizë.

Edhe, me maje të drapërit është dashtë me marrë komplet kashtën me qu nalt dhe gradualisht me i shtri plafat. E trapazanin është dashtë me pastru se nuk ka pas sene me vizllu, orenditë e këto, që ton ditën me mbetë me leckë n'dorë. Atëherë nuk ka pas n'atë kohë, dhe ti e ke marr një xham, se qetkë nuk ka pas do të thotë nuk ka egzistu qetka, sot që lahen me qetkë tepihat, n'atë kohë s'ka ekzgistu, është marrë nje xham dhe është grry trapazani, trapazani është grry me xham, tan kohën e ke grry, derisa e ke zbardhë mirëpo atë grrymjen e ke bo me ujë, do të thotë uji ka qenë një shtytës i zbardhjes së trapazanit, e ke grry. Edhe tokën e ke marrë e ke vaditë, fshisë nuk ka pas por ka pas rometa, rometat jon mjell, lloj bime ajo, nuk është përdor për kurgjo tjetër përveç se me fshi oborrin, për me fshi odën, me fshi qilerin apo fllanikun qysh i thuhet n'kohë të sodit edhe varësisht prej cilit vend ku është përdorë.

Edhe dikun tjetër është shumë interesant, e mbaj në mend nanën teme, me ble bukë të shtetit u kon diçka një premi shumë e madhe, se buka e shtetit është konsideru si niveli ma i naltë i shoqërisë nëse ti e blen bukën e shtetit. Do të thotë, nana jem, ka gatu, ka gatu bukë në tepsija, masdore, pogaçe, kuleq të rrotullum që sot nuk egzistojnë ata kuleq të rrotullum (buzëqeshë) edhe tashti pogaçet kur i marojke... original pogaçe, pa kos, pa jogurt, pa ujë mineral se sot me këto përdoret, edhe me bikarbon, do të thotë pa këto elemente; edhe e merke pogaçen para se me shti n'furrë, e marke pogaçen, e qitke mbi plloqa t'shporetit. Në atë kohë e kemi përdorë shporetin me dru shumë, se rryma ka qenë jashtëzakonisht shtrejtë dhe ti nëse e përdorë shporetin e rrymës ajo gru është konsideru e pa zoja, do të thotë ajo gru e cila nuk din me menagju me elemente të shpisë, hargjon rrymë, e hargjon ujë... Kështu ka qenë mentaliteti në atë kohë.

Dhe gratë jonë mundu sado kudo, vërtetë me kursy se standardi ka qenë jashtëzakonisht i ulët, tashti kur e marrke e pjeke niher mbi plloça të shporetit, ai shporeti u skuçke, plloçat u skuçshin dhe pogaçja u qitke mbi plloça. Tash ato rrathët e hekurit i mbetshin pogaçes në të dy anët, dhe e marrke e qitke në tepsi dhe e shtike n'furrë, po koren të cilën e krijojke pogaçja ishte një kore, kaq {tregon madhësinë me duar} 1 cm e madhe, e me zvogëlu koren se ka qenë shumë e pamundur me hongër pogaçen. Atëherë e marrke nana hekurin, këtë hekur... këtë xham dhe me një letër anash bajagi të trashë, e marrke e grryke pogaçen në të gjitha anët. Do të thotë, është dashtë xhami me qenë grrysi i pogaçes dhe atë pogaçe e kemi honger me long, me specat turshi, me long me djath; nese s'ka pas long, nëse s'ka pas djath, do të thotë me ujë të specave. Dhe ti e ke hongër dhe ty nuk t'ka bo përshtypje a ki pulë në sofër, a s'ki pulë, a ki patate apo oriz apo diçka, do të thotë, ty s'tka bo përshtypje dhe t'ka knaq ajo pogaçe, era, forma e pregaditjes edhe, ajo mospritja kur po kryhet pogaçja me marrë edhe me hongër, me dal qashtu të nxehtë. Ose si çobanë kur kemi shku... Gruja e axhës t'nanës u qojke shumë herët në mëngjes dhe bojke bukë të vogla, dhe secilit, jo një të katërten apo gjysmën e bukës, por një bukë komplet dhe atë bukë na e mushke na e qitke me mazë, me djath, me long. Edhe ujë ke pi, se s'ke pas shishe atëherë me marë me veti, ke pi kudo që ke hasë, do të thotë je e eqtu, e ke ditë përafërsisht ku ka burime ku ka kroje të ujit ose ku ka grumbull të ujit, edhe je përkulë në gjunjë, dy durte i ke qitë edhe je përkulë ke pi ujë. Edhe asnjëherë nuk jemi s'mu asnjëherë nuk kemi pasë ndonjë sëmundje ngjitëse apo çka po di unë.

Do të thotë kjo ka qenë ajo periudhë t'cilën me t'vërtetë e përkujtoj me një nostalgji shumë të madhe, se atë që unë kam kalu më mungon edhe sot. Edhe ajo erë e pogaçes, edhe ajo erë e barit ose e asaj qershie, erë që i kemi marrë prej qershisë, apo ajo erë e malit apo ajo erë që kudo që ti ke lëvizë, do të thotë të mungon në jetën e përditshme. Kudo që kom shku sidomos sot, kur kaloj nëpër ato pjesë, se shumë shpesh shkoj me nipa edhe me mbesa. I kom gjithsej 25 nipa edhe mbesa që jon fëmijë të motrave dhe vllaznive, stërnipa dhe stërnbesa, shumë shpesh shkojna në ato vende me i vizitu. Dhe, për çdo detal, për çdo pëllambë që unë e kom shkel i'u jap një shpjegim të veçantë, një ngjarje të veçantë dhe atyre për çudi

i'u vjen interesant. Thojnë "Si është e mundur që në atë kohë, me u mbijetu një jetë e tillë edhe me pas aq shumë kënaqësi, me pas aq shumë kujtime, kujtime të mira, me pas aq shumë nostalgji," përderisa, atyre i'u mungon sot në jetën e përditshme, ndoshta janë kujtime që asnjëherë në jetë s'kom me i harru.

Në atë kohë do të thotë nuk ka pasë detergjent, do të thotë, detergjenti ka egzistuar vetëm në qytet, dhe thuajse ka qenë i paarritshëm për zonat rurale. Zonat rurale kanë egzistuar, kanë mbijetu, vërtetë një jetë ekstreme të varfërisë e të fukarallakut. Më kujtohet si jo fëmijë mirëpo, jo moshë ku me ditë sa madhore, tash i mershim teshat dhe shkojshim në kru, do të thotë aty ku çdo herë e kemi bo bartjen e ujit. Edhe në kru i kemi marrë e kemi mshelë atë tubën e ujit ku ka depërtu uji, e kemi mushë atë koriten e drunit që ka qenë, e kemi mushë me ujë, i kemi marrë teshat i kemi palu edhe n'vend të detergjentit kemi përdorë hirin. Hiri sot që është i drurit që ndizet do të thotë që mbetet. Edhe jonë ulë çka jonë ulë në hi, e kemi marrë perajken edhe i kemi la me perajkë. Faktikisht i kemi rrehë teshat, na i kemi rrehë teshat me perajkë. Nuk ka pas kisi tel të teshave, do të thotë shtrirjen apo tharjen e tyre e kemi bo nëpër gardh, u kon gardhi rreth e rreth shpisë. Dhe kur u bojke tharja e tyre kur i marrshim me i palu plot buba, plot insekte, plot karrabishta; atëherë i shkunjshim prej krejt ktyne insekteve, atëherë i marrshim, i palojschim, i dërgojschim në shpi.

Karakteristikë tjetër si fëmijë që e kom në memorie jonë edhe ngjarjet e gjyshit i cili ka spjegu do të thotë në atë kohë. Edhe çdo herë, me një porosi ndoshta ka pas rastin kur i kemi thonë jo, nuk është qashtu, apo jo nuk pajtona... Se edhe si fëmijë kemi qenë të indoktrinuar, me marksizëm, me leninizëm e me socializëm. Edhe nëse dikush ka folë naj fjalë të keqe për shtetin ose dikush ka thonë noj fjalë të keqe për partizanë do të thotë ti e ke kundërshtu. Ashtu ke qenë i mësum, dhe çdo herë e dij fjalën e gjyshit, edhe sot ka mbetë ajo fjalë edhe në familje "Hajt, hajt, se ju nuk e dini se çka është shkau, ditën t'lëmon e natën mendon qysh me t'mytë". Kjo ka qenë gjithmonë porosia e tina për shumë arsye, do të thotë sot e di ngjarjen, e di pse çdo herë e ka thonë. Ai ka qenë vetë i nënti vëlla, dhe tetë vëllezërit e tij kanë përfunduar në lufta të ndryshme të Luftës së Parë Botërore dhe Luftës së Dytë Botërore, çdo herë në kundërshtime me regjimin në atë kohë. N'kundërshtime me etninë serbo-kroate-slllovene gjatë periudhës së Luftës së Parë Botërore, dhe çdo herë në kundërshtime me sistemin antifashist që është... që ka qenë i instaluar në atë kohë. Ky ka qenë në qetat e Shaban Polluzhës, dhe mbas përfundimit të luftës ka nejt thuajse pesë vite në mal, e në atë kohë personi i cili ka ndejtë në mal është thirrë kaçak. Ka nejtë në mal do të thotë, të mos drejtës të takimit me familje, dhe ndjekjes do të thotë të arrestimit; o ekzekutim, o burgime të përjetshme që i kanë dërgu në Goli Otok dhe pjesë të ndryshme në Idrizom të Maqedonisë, një nga burgjet më famëkeqëse që kanë egzistuar në atë kohë.

Gjyshi detyrohet komplet pasurinë e familjes me shitë, detyrohet me ishuj Kosovën prej regjimit të Rankoviçit. Do të thotë, e dini regjimi i Rankoviçit në atë kohë ka qenë një regjim i cili ka funksionuar në bazë të atij planit famëkeq të Vaso Qubrilloviçit dhe Ivo Andriçit. Atij memorandumit të famshëm që secili regjim që ka ardhë në skenë në Serbi ka punuar në bazë të atij memorandumit, dhe gjyshi detyrohet komplet pasurinë me shitë dhe me shku për Turqi. E shet pasurinë edhe në atë kohë nuk ka pas vetura, kanë qenë këto kerret me kije, as kuaj nuk ka pas por kerre me kije. Edhe e merr nanën e vet, edhe njonin djalë dhe pjesët e tjera të shpisë do të thotë që i kanë mbetë... rroba e rraçe tjera i hyp në kerr me kije dhe një pjesë të familjes e qon në Shkup. Prej Shkupit mandej kanë shku me tren për Selanik dhe prej Selanikut në fushën e madhe të Edrenes në Turqi, dhe kthehet me marrë pjesën tejtër të familjes, babën tim edhe hallën teme për me shku në Turqi. Kur shkon në kufi me Maqedoninë në atë kohë kur i afrohet kufirit, kufiri mbyllet nuk lejojnë për një kohë të caktuar do të thotë me i dërgu Shqiptarët për Turqi. Ka

qenë një lloj i spatstrimit etnik në atë kohë, do të thotë gjyshit, nana edhe djali tri vjeç i shkojnë për Turqi dhe për pesëdhjetë vite nuk kanë kontakt me axhën.

Në atë kohë do të thotë niveli i arsimit ka qenë shumë i ulët, janë arsimu ndoshta vetëm familje bejlerësh që kanë qenë në atë kohë. Ka qenë një jetë e zakonshme e pa arsime në Kosovë. Mbas pesëdhjetë viteve axha im vjen vetëm si turist në Kosovë këtu pa pasur informacion që familja e tij ekziston në Kosovë, që është një familje shumë e gjanë. Edhe xhamia e madhe ku është në Prishtinë, zakonisht vizitorët prej Turqisë e kanë obligative me vizitu xhaminë e madhe. Dhe vjen në xhami të madhe dhe në bisedë e sipër me njerëz ju tregoj se kush është dhe nga vjen. Dhe një shok i gjyshit thotë “Nuk është e mundur” - gjyshi e ka pas emrin Sherif - dhe thotë “mixha Sherif veq sa e fali xhumanë dhe ka njëzet minuta që veq sa e lëshoj xhaminë dhe shkoj.” Edhe ky stepet, mbetet, edhe nuk mundet me besu që babain e ka gjallë mbas pesëdhjetë viteve edhe po thotë “Që don t’a tregoj edhe shpinë ku e ka.” Kemi qenë vetëm unë dhe nana në shtëpi, edhe po vjen një mesoburrë i zhvill i pashëm me plis në kokë. Se, është traditë shqiptarët që vijnë nga Turqia do të thotë në momentet kur e kalojnë kufirin për Kosovë i vnojnë plisat n’kry, është identifikim i tyre kur të hyjnë në Kosovë. Unë po e shoh me plis dhe ai shoku i gjyshit thotë “A është mixha Sherif këtu?” A ndërkohë gjyshi vetëm ka hy brenda dhe ka dalë jashtë për t’u taku me shokë t’jtjerë, unë i them që jo nuk është këtu, thotë “E keni një mysafir prej Turqisë.” Axha tan kohën ishte në vaj, do të thotë nuk kish element të fillimit të një bisede të përbashkët, me pyet unë kush je tek je nga vjen apo diqka, do të thotë nonstop në vaj. Edhe unë kam qenë shumë e vogël në klasën e shtatë në atë kohë, dhe i them hajde bujrum hin brenda asht nana këtu. Ndërkohë unë e thërras edhe babën në telefon në atë kohë dhe hyn brenda, dhe tregoj mandej axha se kush është tek është dhe plas një vaj, do të thotë që mos me mujtë për pesëdhjetë vite me pas kontakt me axhën tënd. Ndërkohë kur kthehet gjyshi në xhami, dhe shokët i thonë “O mixha Sherif të kish ardhë djali prej Turqisë” dhe ky mbetet dhe thotë “Po çfarë djali se unë nuk di për të kurrë hiq qe pesëdhjetë vjet.” “Jo” i thonë “t’ka ardhë djali prej Turqisë.” Ai i vjetër ka qenë në atë kohë, se gjyshi ka vdekë 98 vjeç...ka jetu 98 vjeç.

Edhe vjen ai prej xhamisë dhe në momentin kur hyn brenda axha mbetë, shtanget, do të thotë një përjetim shumë i randë, ndoshta një vuajtje që e ka bartë për pesëdhjetë vite. Ndjestë pastë se ka vdekë vitin e kalum, edhe gjyshi e vëren që ai bllokohet shtanget, nuk mundet me qit za prej goje. I kthehet bukalisht me këto fjalë {ngrit zërin} “Hajde bre magar çka je ka bon... a kan burri, çka m’i ke qitë këta lotë edhe hajde merrëm n’gryk, përçafëm.” Ndërkohë gjyshi asnjë pikë lot, edhe nuk u jepke që edhe ai si prind e ka bartë atë dhimbjen shpirtnore. Që mos me ditë për pesëdhjetë vjet ku e ke pjesën tjetër të familjës, një përjetim do të thotë që ka qenë shumë i rëndë brenda në familje. Ka qenë një përjetim shumë i këndshëm që mbas pesëdhjetë viteve jemi bashku me axhën, do të thotë që sot e atë ditë kemi kontakte familjare shumë të rregullta. Njëjtë edhe axha i ka tetë fëmijë, pesë djem e tri vajza, pa e ditë do të thotë asnjëherë aspektin familjar kush sa fëmijë i ka. Kështu jemi të barabartë që të gjithë e flasin gjuhën shqipe që të gjithë janë jashtëzakonisht shumë të lidhur me neve këtu në Kosovë. Do të thotë ai përjetim familjar aq sa ka qenë i mërzitshëm, po aq ka qenë edhe i këndshëm.

Rinia

[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarën për rininë e saj.]

Nazlije Bala: Në ndërkohë ndërliiden përkeqësimi i situatës në Kosovë, menjëherë mbas luftës mbas vdekjes së Titos në atë kohë. E mbaj mend për çdo vjet u mbajshin ato një minutë heshtje për... sa Maj ka qenë nuk e di nuk e mbaj mend... 25 maj, shkollat organizonin një minutë heshtje. Isha në klasën e

shtatë, dhe një minutë heshtje dhe ti si femijë normal, që janë disa situata të tilla, plas edhe buzëqeshja edhe krejt ato... edhe mu përnihere më plasë gazi për me keshë edhe nuk ndalem asnjëherë, për asnjë moment. Tërë kohën sa ka qenë ajo një minutë heshtje unë kam keshë, atëherë u qu konserciumi i arsimtarëve në shkollë mbledhje për me m'dënu si kontrarevolucionare, si rebeliste, se e kam prishë atmosferën e një minutë heshtjes, me mbajtë mledhje në shkollë me m'përrjashtu prej shkollës. Më përjashtun faktikisht prej shkollës pse kom keshë gjatë qasaj një minutë heshtje që ka qenë. Atëherë ndërmoren masa ndaj prindit i cili ishte kryetëknik në ambulancën e Ramiz Sadikut. E shkarkuan prej kryetëknikut do të thotë e lanë vetëm teknik i thjeshtë, atëherë filloi diferencimi brenda për brenda familjës, vëllau ku ishte në marëdhënie pune atëherë si udhëheqës i njësitit të zjarrëfiksëve këtu në Prishtinë, poashtu diferencimi ndaj motrës e cila ishte bursiste e kombinatit të Ramiz Sadikut i'a ndalun bursën në Fakultetin Ekonomik.

Do të thotë elemente të ndryshme që ti për herë të parë si fëmijë, prapë i them fëmijë, se fëmijë është edhe klasa e shtatë ku i kam përjetu qysh thojnë një fjalë ata dhëmbët e parë te atij regjimi, dhe madje filluan sulmet e ndryshme që u bëjshin gjatë kohës së mbëmjeve. Filluan organizimet e mitingjeve të ndryshme në atë periudhë madje filluan edhe organizimi i demonstratave të 81-shit. Kam qenë aktive në çdo lloj demonstrate që është organizu në Prishtinë, kryesisht edhe pse e vogël ndoshta edhe pse me trup shumë shtatë-shkurtë kam ditë me bajtë material propagandistik, sidomos thirrjet kur u bojshin për demonstrata, natën me dal me ngjitë thujse në çdo derë, në çdo shtëpi. Në atë kohë do të thotë, i kam njoftë një pjesë bajagi të madhe të grupeve, në atë kohë janë qujtë grupe marksiste-leniniste që kanë qenë kundër regjimit të Serbisë. Kanë qenë për shpalljen e Kosovës Republikë, me të drejtë të plotë në atë kohë në ish Jugosllavi. S'do të hyj të flas me emra, që mbas 81-tës, 99% prej tyre janë arrestu dhe janë dënu me dënime drakonike, me 25 vjet burgim me 18, 17, 20 me familje t'tana janë persekutu. Familje të tana janë diferencu. Djalin e tezës e kam pas njërin ndër ish të burgosurit politik në atë kohë; me tezën kemi qenë shumë afër me shtëpi vetëm një muri na ka nda. Mandej ka qenë rrethi tjetër familjar që ka ardhë pas 81-shit, arrestimet, fluksi i arrestimeve sidomos të rinjëve në atë kohë.

Mandej fillon diferencimi, ndryshimi i programeve arsimore nga regjimi i Slllobodan Millosheviçit, se ndryshon do të thotë, regjimi jo i drejtëpërdrejtë prej Millosheviçit, por në atë kohë ka qenë periudha e riformatimit të them kështu i Lëvizjes Komuniste të Jugosllavisë. Mirëpo çdo herë me pretendime ultranacionaliste nga ana e federatës së Serbisë, në atë kohë komponentë të veçantë dhe fokus të veçantë e kanë pas Kosovën. Mandej filloi periudha do të thotë e largimit të njerëzve nga puna jo drejtëpërdrejt nga puna, por ulja e posteve aty ku ka pas poste kyçe. Shqiptarët i kanë shkark nga postet dhe i kanë zëvendësuar me serb sidomos të nivelit komunal, të gjykatave, nivelit të këshillit ekzekutiv, do të thotë veç ke fillu ti me i hetu elementet e para të asaj politike ekspansioniste që ka qenë e Serbisë ndaj Kosovës dhe ndaj popullit kosovar. Mandej fillon periudha e shkollës së mesme, ndasitë që unë me klasa i kom pa, i kom përjetu dhe se si shkollë e mesme çdo herë kemi pas ndërrimin mbas dite ndërsa ndërrimin para dite e kanë pas serbët. Filluan ato ankesat e sërbeve në Serbi se gjoja "kosovarët, shqiptarët po na dhunojnë, po na rrahin" do të thotë lloj-lloj propagande që asht ba antishqiptare në atë kohë.

Fillon periudha e vitit të tretë dhe vitit të katërt që edhe ma shumë e kemi ndi. Nuk ka pas ekskurzion, nuk ka pas mbramje të maturës, fillon ai diferencimi brenda për brenda policisë të Kosovës ku i shkarkojnë do të thotë policët shqiptarë. Jo shkarkim i drejtëpërdrejt, por i kushtëzojnë me "A e pranon shtetin e Serbisë?" Mandej fillon periudha e vitit '88 demonstratat dhe grevat që u organizuan anë e kand Kosovës, grevat e famshme të minatorëve në Stari Trg, grevat e studentëve në sallën 1 Tetori, do të thotë ku kam

qëndru po aq kohë sa kanë ekzistuar grevat e studentave, për arsye se kam qenë studente në atë kohë. Isha në vitin e parë... vitin e dytë të studimeve të Fakultetit Ekonomik, dhe vjen periudha e vitit '89 ku sublimohet komplet autonomia e Kosovës, përderisa nuk ndaleshin persekutimet e regjimit të Serbisë dhe politikës së Serbisë ndaj shiptarëve në çdo nivel të jetës. Në vitin '89 mbyllet shkollat, e dini për shqiptarë, dhe kyçna drejtëpërdrejt në Këshillin për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut. Në atë kohë është formu Këshilli si formacioni i parë se nuk ka pas as LDK, nuk ka pas as Amnesty International në Kosovë, nuk ka pas as QIK [Qendra për Informimin e Kosovës], absolutisht asgjë. I vetmi institucion i cili filloi të organizoj jetën paralele ka qenë formimi i Këshillit me 10 dhjetor të vitit '89, në prag të deklaratës universale për të drejtave të njeriut që është... që festohet kudo në botë.

Periudha e rinisë ka kalu nëpër disa procese, procese ndoshta që vetvetiu e kam përjetu një transformim të tillë, apo procese ku kemi pas identifikime si të rinjë, si adoleshentë po them. Në atë kohë kanë egzistuar, dhe kanë fillu faktikisht kudo në botë lëvizjet e hipikëve, dhe pankerave. Kanë qenë këto edhe në Kosovë, dhe me të cilin jemi identifikuar, se a je hipikë, a je panker. Unë për vete kam qenë një lloj pankerice. Kam veshë çdo herë farmerka, apo i ke pas të shkruara në pjesë të ndryshme apo në shpinë, apo në xhep. Pastaj ke bërë lekcionet e tyre, sa më shumë që i mbanë të pa lara farmerkat, aq më shumë "in" je pankerizmit. Do të thotë kjo ka qenë një lloj forme, një lloj metode me mbajtje çka po di unë, penjë të ndryshëm nëpër duar, një proces tjetër i fillimeve të para, vitit të parë, dhe vitit të dytë, transformim total do të thotë. Ndoshta kam qenë më eksplozive, më e rreptë, më radikale në momente të ndryshme ndoshta ka qenë një refuzim kundër padrejtësisë, atë e ke shfaq me rebelizëm. Është moshë shumë delikate, shumë e ndjeshme do të thotë që ti nuk akcepton, nuk pranon absolutisht kurgjë. Ka pas raste kur jom përleshë, me përleshje dhe kacafytje, bukalisht, me grupe të ndryshme edhe me djem, me mashkuj brenda në shkollë.

Ndoshta ka pas edhe momente ku absolutisht e kam qujtë veten si një lidere e klasës, dhe klasa ka ba çka kam dashtë unë me u ba, jo çka kanë dashtë ata, por unë bukalisht çka kom dashtë me ba në klasë. Me ikë prej orës, me organizu ikjen kolektive, me prishë qetësinë brenda në klasë, me i nxjerrë me dhunë nxansat tjerë prej klasës... nëse i'a kemi pas inati një profesori, ose një profesoreshe. Ka qenë një rebelizëm, mirëpo një rebelizëm që është përcjell me moshën e adoleshencës që kush jam unë, kërkush hiç, a din, ndoshta nuk është mirë me krahasu, vetëm unë jam Zot në këtë tokë dhe absolutisht kërkush tjetër. Do të thotë kjo ka qenë ajo periudhë, dhe periudhë tjetër e rinisë, edhe pse ka ekzistuar ky transformim, është shumë interesant çdo herë e kam përcjell botën, se çka është ka ndodhë. I kam ndëgjju Pink Floyd, Duran Duran, Bee Gees, Abba. Ka qenë një periudhë në atë kohë ku ata kanë qenë shumë të famshëm. Periudha tjetër do të thotë filluan me u hap aty-këtu diskotekat, diskoteka në Sallën e Kuqe në Boro e Ramiz, diskoteka në bodrum të Hotel Grandit, pjesëmarrja në diskoteka, dhe je identifikuar nëse ke ditë me vallëzu. Unë për veti kam harru me cekë që kam qenë një vallëtare, do thotë jo vallëtare nëpër televizion asi... por thjeshtë kam marrë pjesë në shoqëri kulturo-artistike "Hivzi Sylejmani" që është hapë afër shtëpisë time në bashkësi lokale çdo herë kam marrë pjesë. Kemi ushtru, sa kemi ushtru në periudhë që u kanë e caktuar, atëherë e kemi lëshu muzikën Pink Floyd, Bee Gees-at, Abba, do të thotë kemi kërcy, edhe kemi lujtë deri në mëngjes. Aty janë hapat e parë ku ti i merr me mësu çka është Break Dance, çka është Cha Cha Cha, çka është Samba, të gjitha këto. Do të thotë, jonë kanë transformime në mes vete që është shkëputje totale prej fëmijërisë tënde. Do të thotë vallëzim, hapat si kam harru, edhe sot identifikohem si një vallëtare jashtëzakonisht e mire. Çfarëdo lloj valle, qoftë ajo popullore, qoftë ajo zbavitëse, e kam taktin që vallëzoj. Një element tjetër çka e karakterizoj do të thotë, edhe në atë kohë i kemi vërejtë ndasitë në shoqëri.

Unë për vete kam qenë, edhe pse shumë “dreq”, një problematike në grup, kudo që kam vepru mësimi ka qenë prioriteti kryesor për mu. Prej klasës të parë deri në vitin e dytë të shkollës të mesme, kurrë unë asnjëherë asnjë katër nuk e kam pas në librezë, as në dëftesë. Kam qenë nxënëse shembullore çdo herë, edhe në atë kohë nxënësat shembullore kryesisht i kanë orient në Gjimnaz Sami Frashëri që është në Prishtinë, edhe Gjimnazi që ka qenë Xhevdet Doda tek Tre Sheshirat. Po në këto dy Gjimnaze kanë pas të drejtë për t’u regjistru vetëm fëmija e atyre që kanë qenë në pozita, fëmijët e drejtorave, fëmijët kryetarë partish komuniste, socialiste, çka po di unë, që kanë udhëheq shtetin. Përderisa ti që ke qenë një kategori e mesme e shoqërisë, ty të kanë orient, edhe pse nuk i mohoj se edhe ato kanë qenë shkolla të mira, mirpo ka ekzistuar kjo ndasi. Nëse ke shku në Gjimnaz i ke vërejtë, do të thotë se aty ka fëmijë vetëm, do të them shumë popullorqe “fëmijë të Buxhovanave,” do të thotë që i kanë pasur shtëpiat në Tasligje, në Dragodan, në Breg të Diellit, do të thotë fëmijët që i kanë pas t’atnat të mirat në jetë. Derisa ty të kanë orientu në Normale, ose në shkollë të Bujqësisë, ose shkollë Ekonomike, edhe shkolla Teknike 19 Nëntori. Do të thotë i ke vërejtë këto ndasi, brenda për brenda qytetit. Të mos flas për ndasitë që i kanë ba fshat-qytet, ajo moshë, ajo gjeneratë do të thotë nuk kanë pas qasje në shkollat më të mira në Prishtinë. Për Prishtinën thuajse kjo gjendje ka qenë kudo në Kosovë. E dyta, janë dhanë edhe përparësi prej trevës nga ke ardhë, nëse ke qenë i Prizrenit, nëse ke qenë i Gjakovës, ke pas përparësi shumë më të mëdhaja. Nëse ke qenë prej Podujevës, apo prej Vushtrrisë, apo Mitrovicës, përparësitë jonë kanë shumë të vogla. Apo nëse ai numër nuk është plotësu edhe e kanë plotësu me ty, sa mos me thënë që nuk ka nxanësa prej këtyre pjesëve tjera, do të thotë edhe në ato mese ku si moshë rinore të cilat i kom kalu, e kom përjetu Korzoja çka është.

Nuk e di, ju se keni përjetu çka është Korzoja, me dal prej orës varësisht prej cila stinë ka ekzistuar, do të thotë siç dilshim prej orës 18:00 e deri kah ora 22:00. Ato lëvizjet që bëheshin nëpër, tash Sheshi, ku është Korzo në katër trakëshe, do të thotë dy traka të njerëzve të lëvizjeve që kanë qenë dy anët e rrugëve, tash ku janë si lloj trote, dhe mesi i Korozos, do të thotë prej hyrjes së Parlamentit deri te Hotel Grandi ka qenë shëtitorja. Për çdo mbrëmje që kemi dalë, në atë kohë nuk ka pas kafiteri të cilat janë sot. Ka pas restaurante, mirëpo në restaurante, ti, si e re nuk ke mujtë me hy. Ka qenë diçka e pa moralshme, me hy ti në restaurant, dhe me pi një lëng, një Coca-Cola, një kafe, është thirrë amoralitet. Nëse ti ke hy brenda në restaurant me bo një freski (qeshë) të shpirtit, apo një freski me bo që është nevojë shumë normale njerëzore, do të thotë është konsideru amoralitet nëse ti ke hy në restaurant, edhe nëse ti ke hi në restaurant do të thotë i ke pas të gjitha, ato frika, mos rastësisht dikush prej familjes po më sheh që kam hyrë në restaurant... kjo ka qenë ai mentalitet dhe ma vonë kjo tabu. E çka ke bo ti në Korzo, e ke ble një fitil fara edhe je ulë, na i themi te rrethi, ku është përmendorja e Zahir Pajazitit. Ai rrethi, ato ulëset që janë, do të thotë si shoqëri zakonisht jemi mbledhë tek ato ulëse, për me u ulë për me hangër fara. Tash mundeni me marrë me mend, pa pas të drejtë me hy në restaurant një gotë ujë për me pi, do të thotë ky është konsideru amoralitet në shoqëri, tjetër çka është konsideru, do të thotë që unë e kam përjetu.

Në atë periudhë nëse i ke lëshu thonjët është konsideru amoralitet, nëse i ke ly thonjët me llak, është konsideru amoralitet, nëse ke vnu make-up, apo Labello, apo një laps të zi është konsideru amoralitet. Nëse ke ba ngjyrosjen e flokut është konsideru diçka e pahijshme, “Pse vajza e re me i ngjyros flokët?!” Do të thotë këto kanë qenë krejt paragjykime dhe stereotipe që na u kanë ba në atë kohë, të cilat personalisht i kam përjetu. Nëse ke veshë miniq, do të thotë fund të shkurtë, është konsideru amoralitet. Shtikllat kanë qenë elemente që ty të kanë identifiku të amoralshme. Shembull e kemi pas një periudhë strikte, kur ti ke pas të drejtë me dalë dhe kur ti nuk ke pas të drejtë me dalë. Do të thotë deri në ora 19:00 ke pas të drejtë me dalë dhe në ora 19:00 me u kthy në shtëpi edhe me shiku filmin e vizatum, edhe pse e ke konsideru vetën të rritur, do të thotë e rritur në periudhë kohe kur ti don me dalë. Kanë qenë dy-tri

kafiteri në atë kohë sidomos ka qenë kafiteria Xheni. Ka qenë andërr e çdo moshatareje time në atë kohë për me u ulë, edhe për të pi një ekspreso të gjatë, se ekspreson vetëm e kemi ndi me veshë por asnjëherë pa e shiju ekspreson. Do të thotë elemente shumë, shumë të ndryshme si moshë rinore ku ke pas periudha strikte që familja ty të ka përcaktu sjelljen në shoqëri.

Ndërkohë e vërej edhe transformimin familjar, motra e madhe, jo më e madhja prej fëmijëve mirëpo si motër që është më e madhja, filloi të shkojë me një djalë. E gjet një djalë, ai sot është me të, sot është e martume ka tridhjetë e pesë vite martesë, ka nipa, e ka mbesa. Mirëpo, më kujtohet në atë kohë kundërshtimi i familjës, pse e ka gjetë, refuzimi total që “nuk lejojnë ti me pas martesë me atë djalë” pse nuk e ka vetë familjen, do të thotë kundërshtim familjar, kudo, jo vetëm në familjen time. Përderisa motra e dytë kur e gjet tash bashkëshortin të cilin e ka, ishte tash një gëzim familjar, edhe pse të pa fejum ata veç kishin fillu të argëtoheshin në mes veti. Ai vinte e merrte te dera, e dijsim që ëshë me Jonuzin do të thotë po del, e njihshin familjarisht... Do të thotë e vëren periudhën e transformimit.

Përderisa te unë në atë periudhë do të thotë, kam pas krejt interesa të tjera. Edhe pse bashkëmoshatarë më të afërmit e familjes time, dhe tash nana e ndjente vetën nganjëherë në situatë të pa lakmueshme, se vajzat e axhës të saj shembull, apo vajzat e tezës, ato qika të shtëpisë duke u veshë në asi funda të gjatë, duke maru goblena me grep, e me krejt këto... e interesimet e mia kanë qenë diametralisht të kundërta prej tyre. E tash nana për me e ndi veten të barabartë në rrethin ku ajo ka jetu, me rrethin me të cilin ajo ka pas kontakt çdo herë, dilte në treg, përpara ka qenë vetëm tregu, nuk ka pas shitore, më blinte një goblenë, më blinte demse thirren, ata penjtë e goblenit, edhe m'i sjellte në shtëpi. Edhe thoshte prej sot ke me qëndisë goblen. Unë as pa e ditë as me qëndis goblen, as absolutisht hiq kurgjë. Ose dilte më blinte një grep me një jomak, jonë qenë jomaka të bardhë, drap, me ngjyra të ndryshme, edhe ma bijke thojke “Merre s'ke qare pa u mësu me maru me grep”. Unë tash e kuptoj pse e ka bërë këtë trysni të tillë ndaj meje, por unë asnjëherë s'e kam shfaqë atë interes. E tash, unë e merrsha atë grepin e atë jomakun e shkojsha te vajza e tezës, te ajo teza të cilën e kemi pas shumë afër, një muri që na ka nda, dhe i thosha “Merre edhe qitmi do rena, se unë për veti nuk disha” edhe “qitmi do rena se kur t'shkoj n'shpi t'i tregoj nanës që kam punu me grep.” Në momentin kur shkojsha në shtëpi, lajmi i parë, lajm bombastik do të thotë, për nanën “Nana qe i kam punu do rena”. I merrte, i shikojke qysh i kam qitë ata rena, a kam ditë a nuk kam ditë. Dhe bukalisht unë nuk i kisha qitë ata rena, mirëpo do të thotë ka qenë mentalitet i çdo nane, ku çdo nënë e ka konsideru që vajza duhet me u përgaditë për burrë, do të thotë, tash je në moshë madhore, në moshë të pjekurisë, në moshë që ti duhesh me hy në obligime familjare, dhe gradualisht ti me përgaditë veten për me hy në sistemin e martesës.

Për me hy në sistemin e martesës është dashtë me ditë me la, me fshi, me hekuros, me maru tentene, me maru bukë, e krejt këto elemente, që është dashtë ti me u pajisë si vajzë brenda në shtëpi... ani me të konsideru një familje tjetër që ti je e denjë për martesë, apo që je për atë familje. Elementet të cilat m'a përshkruajnë rininë në shumë detaje, ose nejat nëpër dasma, në kanagjegje. Unë di me i ra deficit, edhe di me knu shumë mirë, sidomos këngë të vajzave, do të thotë të kanagjegjeve, ose Nata e Kanës, kur knohet Kana. Nuk e di, se tash nuk janë më ato tradita, po në atë kohë, në atë periudhë, kanë qenë shumë interesant që i kujtoj, e i di në detaje të gjitha. Tash mburrja do të thotë, në cilën anë është mburrë nana jem me mu, në formën qysh kom ditë me i ra deficit, do të thotë se është konsideru tamam qikë e shtëpisë, se po din me i ra deficit, në formën e këndimit edhe në formën e vallëzimit, në formën e pritjes dhe përcjelljes të atyne njerëzve të cilët i ke ftu ti për një aheng familjar, qoftë darsëm, qoftë kanagjegj. Do të thotë, këto janë elemente që gjenerata e vjetër i kanë konsideru tek vajzat e reja, do të thotë parapërgatitje për moshën të pjekurisë dhe moshën të cilën ti duhesh me hynë martesë. Përderisa në

anën tjetër, kto në asnjë nuk kanë pas interesim, shumë herë kam ra në konflikt me nanën, se baba ka qenë ma i prirun gjithmonë në aspektin edukativ. Do të thotë, shumë herë kam ra në konflikt me nanën, kur i thosha nanës “Unë nuk muj me paramendu, shembull nuk muj me paramendu veten që unë duhet të shkoj nuse aty ku janë tridhjetë vetë, edhe duhet t’rri me tabak me çaja,” do të thotë ajo ishte një kundërshtim. Ose kur i thosha nanës “Unë nuk muj me paramendu vetën, në fustana të nusërisë, se nuk është diçka që unë e pretendoj ose e marrë.” Do të thotë ishte kundërshtim shumë i madh, ose çdo herë në kundërshtim, se ajo vraponte me m’a përgaditë qezin, me m’a përgaditë pajën. Përderisa n’anën tjetër unë nuk shfaqsha absolutisht interes ndaj atyne leckave, ndaj atyne çka e kanë konsideru qeiz: tentene, kllobodan, mushna, toled, krejt këto... Ajo krejt i ka kry vetë, i ka përgaditë, dhe sot, e atë ditë, e kam atë qeiz, që e kam kujtim prej nanës. Është një memorie, dhe kohë pas kohe i marr për shkak të ajrosjes, asnjëherë nuk kam me i hupë, do të thotë është një kujtim që e kam brenda. Kur e hapi atë valixhe më dalin të gjitha ato kujtime për një herë, të asaj moshës të rinisë ose tentativën e nanës.

Unë më shumë tip sportiste, do të thotë me farmerka, me trenerka, dhe tentativa e nanës çdo herë me m’pru në atë imazhin e përdorimit të fundave të gjatë deri këtu {tregon gjatësinë e fundit mbi gju}. Do të thotë se vajzat e reja kanë bajtë funda të gjatë deri këtu, jo pantollona, jo trenerka, dhe unë kam qenë krejt tjetër tip i kombit. Dilke, shkojke te rrobaqepësi, se nuk ka pas me ble do të thotë, kryesisht e ke ble një copë të mëndafshhtë çfarëdo ka qenë, edhe nana ka shku te rrobaqepësja, pa m’a matë masën, pa kurgjë hiç. Ajo e ka pre atë fund qysh e ka paramendu, qysh ka dashtë me pre, qysh mu ka dashtë me më pa brenda atyre elementeve, do të thotë si parapërgaditje për të qenurit gru apo të qenurit nënë. Përderisa orientimet e mia kanë qenë komplet të kundërta jeta, rinia, mosha, edukimi, arsimimi, kontakti me botën e dytë, se në atë kohë e kemi pas vetëm Kosovën, jemi pështjellë brenda në Kosovë, që s’ke pas qasje as në Prizren, as në Mitrovicë, as në Gjakovë. Ti ke pas qasje vetëm kur të kanë dërgu në ekskursion, por jo në aspektin individual si sot qysh mledhen shoqet, “hajde po shkojmë në Prizren ose hajde po shkojmë në Mirtovicë është një restaurant i mirë” një argëtim, do të thotë të vikendeve. Në atë kohë s’kanë ekzistuar, se s’ke pas.

E mbaj mend, jo e mbaj mend, por kjo është një shumë e vërtetë do të thotë që në rrethin familjar dhe në rrethin ku unë jam rritë, kam qenë e para femër që e kam marrë lejen e kerrit. Interesimi im ka qenë çdo herë vetura. Sa herë e kom marrë, e kom vjedhë kerrin e vëllaut do të thotë i’a kam vjedhë çelësat, bukalisht ai ka ardhë prej punës, ka hi me flejtë, unë kam shku i kam marrë çelësat, edhe jo nëpër qytet, se s’kom guxu shumë nëpër qytet, por rrethit të mahallës... sa me ditë me ba ndërrimin e shpejtësisë, kur duhet me ndalë, kur duhet me nisë, edhe këto elemente përderisa një çudi ka ndodhë. Po tregoj interesimin, do të thotë që kam qenë e para që kam marrë lejen e kerrit, edhe një rast nuk është moshë rinore por duhet demonstru, isha në Shkup me misionin e OSBE-së, dhe e prisnim një delegacion.

Unë ndërkohë isha duke ardhë prej Austrisë, shoferi i autobusit të OSBE-së ka pritë, mirëpo ndërkohë ka shku në kafiteri derisa të vjen ai delegacion. Edhe me autobus kish kriju pengesa në Aeroportin e Shkupit, dhe shumë lehtë hy brenda, do të thotë është një element që prej jashtë i hap dyert e autobusit, dhe ka qenë automatik autobusi. Hy brenda e dhezi autobusin, dhe do të thotë krejt ata policë, dhe krejt ata burra kthehen ka unë. Unë shtatë-shkurtë, e vogël edhe tash autobusin, mundeni me paramendu në krahasim me mua, edhe unë e marrë dhe e largoi autobusin prej aty... edhe do të thotë interesimi si femër ishte çdo herë në vetura. Kohë pas kohe kam vozitë edhe motorr, do të thotë motorr, tamam si “Kawasaki” e këto krejt, bicikletën mo, ajo ka qenë qysh prej fëmijërisë. Skijat e para nuk kemi pas mirëpo, di me skiju edhe sot. Në atë kohë do të thotë i kemi marrë këto gajbet e birrave, dhe i kemi pre në katër qoshet e gajbeve, i kemi pre bukalisht katër qoshet e gajbeve do të thotë, vijnë këto plastikat e qarta {demonstron

me duar}. Krrabzat që marojnë nënat xhempera e këto, krrabzat i kemi marrë edhe i kemi nxehtë në gacë, i kemi skuqë, dhe i kemi bo vrimat nëpër këto të plastikës, për me mujtë me e futë konopin, me kriju një shtrëngim për të ndejtur ajo plastikë në këmbë, si lloj skije. Përderisa pjesën e përparme, teknike është përdorë, edhe në atë kohë sikur teknikë përderisa për pjesën e përparme është përdorur ujë të valë, është marrë ujë të valë, që është tamam i valë, do të thotë e kemi futur brenda derisa e kemi vërejtë që është zbutë, dhe shpejtë e shpejtë, e kemi ba kthesën që ti mos me hasë në pengesa kur të fillojsh me skiju. Këto kanë qenë skijat e tona në atë kohë. Sajë të drunit nuk kemi pas, edhe lutja e neve fëmijëve babës për të na siguru një sajë. Ne ishim kallabëllak fëmijë, edhe drunjët kanë qenë për dy vetë, ne ishim pesë-gjashtë vetë. Shkon babai në Ramiz Sadik atje në punëtori edhe bisedon me punëtorët, edhe ata e ndërtojnë një sajë prej ktuhit e deri tek dera {dëfton nga dera e dhomës} edhe çelik krejt hekur, edhe ata mezi e qojshin lagjës te ne. Kështuqë, të pestit, të gjashtit u ulshim në atë sajë, dhe u lëshojshim lagjës teposhtë. Ka ngjarje të pakufijshme...

Zana Rudi: Ti po folë që nuk e ke përkrahë kurrë, nuk ke qenë për këto se çka të janë ofru, por fole pak edhe për interesat e tua se çka jonë konë. Po du me ditë ma konkretisht çka ke bo? Me çfarë aktivitete mandej ke fillu me u marrë, edhe anën e familjes qysh u kon qëndrimi i tyre ndaj krejt kësaj, duke e marrë parasysh situatën?

Nazlije Bala: Po i'u tregoj një detaj shumë të shkurtë, në klasën e dytë, kam shprehë interesim në instrumentet muzikore. Një herë flautës, dhe mandej klarinetit, normal që duhesh me ushtru në flautë për me dalë në klarinetë. Familja si familje dhe ambienti shumë i ngushtë për me i bo ato ushtrimet në flautë me pentagram, me nota, me të gjitha ato... Tash e merrsha flautën, e merrsha fletoren ku i kemi pas pentagramet, në oborr kemi pas lloj-lloj pemë që ka egzistu në oborin tonin, e merrsha flautën, pentagramin, edhe hypsha në kajsi. Aty kom ushtru do të thotë me flautë, asnjëherë s'e kam largu prej vetit, përderisa ndoshta unë kam kriju pengesë në familje, apo ndoshta familjes nuk i'u ka dokë interesant që unë po e marrë flautën, dhe çdo herë me atë elementin "librat, librat, kqyre librin, detyrat." A unë krejt e kryjsha mësimin e mësoja, detyrat i bëja, asnjëherë do të thotë nuk ka egzistu një moment i caktum që unë me shku në shkollë pa i ba detyrat e shtëpisë, ose të shkojë e papërgatitur në shkollë. Mirëpo, ajo ka qenë për mua vetëm detyrat dhe mësimi, ato që na i ka dhënë mësuësja kanë qenë të pamjaftueshme. Ndoshta kam qenë fëmijë hiperaktiv që kam dashtë me u sfidu me çdo gjë... një element të shkurtë të flautës që ëpër dymbëdhjetë vite që nuk e kam ndërprerë. Non-stop kam ushtru, edhe sot di me i ra flautës edhe klarinetit.

Mandej sportin... Sportin nuk e kam ndërpre asnjëherë. Kam marrë pjesë nëpër kroset që janë organizu në Kosovë, qoftë Prishtinë, qoftë Gjilan, Gjakovë, Prizren. Vrapimin asnjëherë s'e pata ndërpre derisa është përkeqësuar komplet situata. Shahin sot e kam hobi, luajsh shumë shpesh, kur të shkoj në familje. Edhe, ende nuk ka dalë një i afërm i jemi që mundet me fitu lojë prej meje në shah. Topin e dua shumë do të thotë, kur dalim në piknik, në natyrë vikendeve me familje kam pasion topin, o futboll, o pasime në duart, ose qysh thuhet ajo në majë të gishtave.

Është një karakterisitkë shumë interesante ndoshta pse kam pasur kontakte të drejtëpërdrejta me bagëtinë qoftë me delet, qoftë me lopët, qoftë shpezë të ndryshëm që kanë egzistu brenda në familje. Sot e kam hobi kalërimin e kuajve, kohë pas kohe, e sidomos kohën e lirë kur e di që e kam vikend, në "Vali Ranch" në Gjilan, nuk është reklamë, por po e them shumë haptas, nga katër apo pesë orë dal me kuaj në natyrë shëtis. Zakonisht ka njerëz që i shoh rrugës, edhe i'u vjen si një lloj çudie femra në majë të kalit

edhe po kalëron me kual nëpër pjesë, sepse konsiderohet diçka e paarritëshme, e pa kapëshme, dhe diçka që femrat nuk duhet me pas atë aftësi.

Aftësi tjetër do të thotë e kam edhe shenjëtarinë-gjuajtjen me pushkë, por jo me pushkë të vërtetë mirëpo pushkë në atë kohë që i kemi pasë, ajrore që i kemi konsideru. Aty kam marrë pjesë në gara në ish-Jugosllavi, thuajse çdo kohë. Do të thotë këto kanë qenë interesimet e mia që familjes time nuk i kanë ba përshtypje, se e kanë mendu që shkëputem total prej mësimit, edhe devijoj në periudhë të caktume. Mirëpo me punë, me seriozitet, me angazhim, i kam bindë që asnjëherë nuk kam deviju prej rrugës të cilës i'a kam përcaktu vetëvetës. Edhe sot e atë ditë i kam këto hobi, që me qefin më të madh i vë në funksion, edhe i përdori.

Ndoshta periudha më e rëndë jo për familjen, por periudha më e rëndë për mua si Nazlie, është kur kam fillu të angazhohem drejtëpërdrejtë në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Nuk kam pas ndonjë pengesë prej familjes që mua të më lejojnë të punoj por kanë pas frikë familja se në atë kohë shumë anëtarë të Këshillit arrestoheshin, burgoseshin. Besa një pjesë shumë e madhe edhe është torturu nga ana e policisë, që e kam përjetu edhe vetë, tortura në forma të ndryshme. Ndoshta pse vajzë shumë e re, ndoshta kanë pas atë frikën e pasojave që mundet njeriu me i pas në organizim pas një periudhe të gjatë kohore. Mirëpo më vonë do të thotë kam pas përkrahjen për tan këto vite rrugëtim të aktivizimit që unë e kam, përkrahjen më të madhe e kam pas prej familjes. Përkrahja më e madhe prej familjes më së pari më ka ardhë duke u nisë prej dy prindërve, prej vëllezërve dhe prej motrave. Jam mundu dhe do të mundohem, që atë pavarësi shpirëtoe që individi e ka brenda vetes, atë orientim personal që individi e ndërton, se duhesh me pasë një qëllim në jetë për me punu me arritë atë qëllim, t'a transferoj tek nipat edhe mbesat e mia. Sot unë mburrem me ta, qe vërtet kanë drejtime, edhe qëllime shumë të qarta, shumë të kristalizume për formën, mënyrën se si do t'a ndërtojnë jetën. Nuk dua as nipat, as mbesat e mia të kalojnë nëpër atë çka unë kam kalu, çfarëdo qofshin ato periduha për asnjë gjeneratë e re që është sot në Kosovë, atë që çdo herë mundohem që ta percjelli tek ata. Mos ta harroj, edhe harresa kolektive, forma e të jetumit si familje se ka ngjarje të ndryshme, edhe prindërit e tu, edhe të dikujt tjetër, e tjetër, shpjegojnë forma të ndryshme të jetesës.

Aktivizmi

[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarin për periudhën e aktivizmit.]

Nazlije Bala: Në Këshillin për të Drejtat e Njeriut, kam fillu të jem anëtare e Këshillit në vitin '89 kur është themelu dhe mbas një periudhe të shkurtë kohore, si aktiviste e drejtëpërdrejtë e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Në Këshill ka ekzistru një punë kolosale, një punë që sot është shumë vështirë për t'a kuptu. Kemi pas të bëjmë drejtëpërdrejtë me terrenin, dhe me gjithë ata që në forma të ndryshme kanë përjetu shkelje të drejtave të njeriut nga regjimi i Milosheviçit deri në periudhën e vitit '99, periudhë të cilën Këshilli edhe sot punon. Kam qenë koordinatorë e terrenit, mirëpo pavarësisht që kam qenë koordinatorë e terrenit, ne nuk i kemi kqyrë si aktivista se kush çfarë detyrash, roli, çfarë përgjegjësie ka. Mirëpo çdo herë ka qenë në fokus dhe interes tonë, në fokus të veçantë, të mbërrijmë te informacioni, të përpilojmë informacionin, të përpilojmë analizën, ta shëndrrojmë në raport. Pastaj këtë raport ta dërgojmë tek agjensionet e ndryshme ndërkombëtare, ambasadave, qeverive të ndryshme, që ta kenë informacionin e plotë, dhe të saktë, në kohë mbi shkeljet e të drejtave të njeriut në kohën e rezimit të Milosheviçit.

Ka ngjarje të papërshtetshme, të cilat i kam përjetu si aktiviste e Këshillit. Du me nda një ngjarje që për mu ka qenë jashtëzakonisht e dhimbshme. Do të thotë kur filluan luftërat në Bosnjë dhe në Kroaci, filloi kolonizimi i Kosovës, me refugjatë nga Knini, dhe me refugjatë nga Bosnja mirëpo në veçanti me refugjatë nga Kroacia, serbë nga Kroacia që i sjellnin në Kosovë. Filluan ndërtimin e kampeve të ndryshme në vende të caktume nëpër Kosovë. Ka qenë kampi refugjatëve afër Vushtrrisë me serbë, që kanë qenë nga Knini dhe pjesë të tjera të Kroacisë, do të thotë refugjatë të cilët vërtetë kanë qenë shumë ekstremë. Një pjesë shumë e madhe e tyre janë veshur si polic rezervistë do të thotë, i'u kanë bashkangjitur forcave policore të Kosovës. Një pjesë shumë e madhe e tyre kanë hy në funksione të ndryshme si gjykatësa, avokatë, prokurorë, në institucione të ndryshme në atë kohë sepse, shqiptarët u dëbuan në atë kohë komplet prej jetës institucionale. Një fëmijë ka qenë trembëdhjetë vjeç i cili është vra me granatë dore, pikërisht nga serbët refugjatë të Kninit, fshatëra shumë të afërta njëra me tjetrën.

Ka qenë ditë Bajrami, Bajrami i Madh. Atë ditë kemi pas ditë pushimi, mirëpo ansjehëre nuk kemi pushu, se e kemi pas në kokë që duhet me qenë në gjendje gatishmërie, që çfarëdo lloj informacioni duhet me shku në zyrë me përgatitë, ose në tërën duke marrë fotografi, varësisht prej rastit. Ka qenë një grumbull i fëmijëve që kanë qenë aty duke lozur në ara. Në arat e tyre do të thotë, bukalisht... edhe kalon vetura e atyre refugjatëve serbë, edhe shumë thjeshtë e merr granatën edhe e hudh tek fëmijët, dhe ky fëmijë trembëdhjetë vjeç vdes. Fëmijë të tjerë plagosen, disa në fraktura, disa në humbje të gjymtyrëve. Të nesërmen ditë, e kishim delegacionin ish-raportuesen speciale të drejtave të njeriut për Ballkan Elizabet Ren, dhe duhej të përgatisja komplet dosjen, komplet materialin, për ngjarjen e ditës së Bajramit; përveç materialeve tjera që çdo herë i kemi pajisur çdo delegacion, që ka ardhë në Kosovë. Ka qenë një fotografi e gjallë, prej fotografisë, deklaratës, raportit javor, raportit tre mujor, raportit gjashtë mujor, dhe raportit vjetor. Çdo herë kemi kriju, kemi përpilu dosje, çdo herë e bazume në fakte, dhe argumente. Atëherë, pa u ndëgjju me njeri tjetrin në telefon, vetëm pse e kemi ndëgjju përmes radios.

Që të gjithë kolegët e mi në atë kohë, ka qenë Ibrahim Makolli, sot është Ministër i Diasporës, ka qenë Mimoza Ahmetaj, sot është Ambasadore në Slloveni. Ka qenë Halimja ajo sot është zyrtare shumë e lartë në Ministrinë e Mbrojtjes... Zina, Fisi, komplet ekipa pa e lajmëru, do të thotë stafin tjetër menaxhues, bacin Adem, Bajram Kelmendin, Nekibja, e gjithë këta veprimtarë të cilët kanë qenë të Këshillit në atë kohë. Kemi punu bashkërisht dhe kemi shku në vendin e ngjarjes, kemi ba fotografimin, kemi ba marrjen e deklaratave, kemi shku në kompani, do të thotë ku bëjnë zhvillim të filmit. E kemi zhvillu komplet filmin, kemi nxjerrë komplet fotografitë, jemi kthyer në zyrë, kemi bërë analizën, kemi përpilu dosjen, do të thotë deri në ora tetë në mëngjes, pa ndërprerë kemi punu si ekip. Në ora dhjetë kishim delegacionin që vinte me Elizabet Ren, me delegacionin e Kombeve të Bashkume. Dhe ka qenë ndoshta, ka qenë ai vullneti, ajo që e kemi ndi shumë obligim, përgjegjësi të madhe do të thotë, për të evidentu dhe argumentu para botës, se cilat lloje, cilat shkelje të drejtave të njeriut bëhen në Kosovë.

Nuk ka egzistuar e drejtë e njeriut, që i njuh bota e mbarë, që i njuh do të thotë Konventat e ndryshme, mbi të cilat shtetet punojnë, e që nuk është shkelë në Kosovë. Unë e shpjegova vetëm një element të thjeshtë i cili ka qenë vullneti, përgatitja, dhe dëshira për me punu. Nodshta familja ime, sa here ata e kanë ditë që unë kam dal nëtet në mëngjes, mirëpo asnjëherë nuk e kom ditë se a do të kthehna e gjallë në shtëpi. Çdo herë e kemi pritë që do të arrestohemi, çdo herë e kemi pritë që kemi me u rrehë prej anës së policisë, çdo herë e kemi pritë që kemi me u kidnapu. Sot një ish-kolegë yni, Xhavit Shala i cili është kidnapu në vitin '98, sot e atë ditë nuk nuk kemi kurrfarë informacioni për të. Po të tregoj elemente që e kemi ditë që kemi me shku në punë, kemi dalë prej shtëpisë në ora tetë, mirëpo asnjëherë nuk kemi pas

asnjë lloj garance që do të kthehemi gjallë dhe shëndoshë e mirë në familjet tona. Ka qenë një punë shumë e madhe, mirëpo që sot mburna.

Për vite t'ana kam shërby si aktiviste e të drejtave të njeriut në Kosovë. Përveç punës si aktiviste jam marrë edhe me aktivitete të tjera, mirëpo që kanë pas gjithmonë lidhshmëri. Kam qenë bashkëpunëtoare e drejtëpërdrejtë me Human Rights Watch, bashkëpunëtoare e drejtëpërdrejtë me Amnesty International, bashkëpunëtoare e drejtëpërdrejtë me shumë televizione ndërkombëtare, CNN, BBC, Sky News, Euro News, do të thotë çdo herë që kemi qenë raportuese të drejtëpërdrejtë mbi ngjarjet në Kosovë. Më vonë jam bashkëpunëtoare, në vitin '97, do të thotë situata veç eskaloi, derisa jam bashkëpunëtoare në misionin e OSBE-s. Do të thotë për atë periudhë kohore sa kam punu në Këshill, kam qenë edhe anëtare e grupit të Rrjetit të Grave të Kosovës. Poashtu kam qenë bashkëthemeluese e Qendrës për Mbrojtje të Grave dhe Fëmijëve në Kosovë, se pritoritet i kemi pas edhe gratë, edhe fëmijët, se burrat e kanë përjetu një lloj dhune, ndërsa gratë kanë përjetu tre fish, katër fish, dhunën brenda për brenda familjes. Kam qenë bashkëpunëtoare e shumë proceseve të ndryshme në Kosovë, të formimit të Shoqatës Nëna Terezë, si shoqatë humanitare, do të thotë bashkëpunëtoare e formimit të Këshillit të Emergjencës, në atë kohë do të thotë që është formu, të Lidhjes të Grave të Kosovës çdo herë do të thotë në lëvizje të barabartë, se çdo herë e kam ndier obligim që të jem pjesëmarrëse në procese. Kam marrë pjesë në shumë konferenca ndërkombëtare çdo herë në fokus të veçantë, prezentimin e Kosovës anë e kënd botës.

Jam nderu me çmime të ndryshme, në vitin 2000 jam nderu me çmimin e Paqes i cili është dhënë për herë të parë nga qeveria franceze, është dhënë për herë të parë në Europë ai çmim. Kom qenë une, dhe tash është Laurate e çmimit Nobel nga Kenia, të dyja kemi pjesëmarrëse të atij çmimi. Dhe çmime të ndryshme do të thotë prej organizmave dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe lokale. Poashtu, bashkëorganizatore e protestave shumë të mëdhaja të grave në Kosovë, në atë kohë që janë bërë. Në atë kohë kemi qenë unë, Igo, Sevdije Ahmeti, Afërdita Saraqini, Vjosa Dobruna, do të thotë një grup jo shumë i madh, Naxhije Buçinca, dhe kërkoj ndjesë nëse nuk përmendi emra të tjerë se nuk po më kujtohen. Bashkëpunëtoare e organizimit të protestave të ndryshme si: Bukë për Drenicën, Marshi për Drenicën, në përkrahje të Luftës të UÇK-së. Madje kontakte të drejtëpërdrejtë me Departamentin Amerikan, me NATO-n, Bashkimin Europian dhe me krejt ata organizma që kanë qenë vendimarrës, kam pas kontakte të drejtëpërdrejtë në këtë drejtim. Më vonë në vitin '97-'98 i'u kom bashkëpunëtoare në Misionin Verifikues në Kosovë, do të thotë në atë kohë ka qenë OSBE dhe KDOM, do të thotë mision tjetër amerikan, mision ushtarak faktikisht ka qenë. Puna ime në OSBE gjegjësisht në Departamentin e të Drejtave të Njeriut është lidhë drejtëpërdrejtë me monitorimin dhe implementimin të marrëveshjes në atë kohë, do të thotë të armëpushimit që është ba në mes forcave të UÇK-së dhe ushtrisë, apo rezhimit të Millosheviçit. Marrëveshje asnjëherë e cila nuk është respektu nga ana e rezhimit të Millosheviçit, përkundrazi është trefishu, katërfishu dhuna në Kosovë.

Lufta

[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarën për kohën e luftës.]

Nazlije Bala: Një rrethim i hekurt artilerik, që filloi në atë kohë, do të thotë filluan masakra të ndryshme. Kam qenë pjesëmarrëse e drejtëpërdrejtë e përpilimit të raportit të rastit të Reçakut, i cili ka ndodhë në vitin '98. Ajo betejë një mujore për luftë për kufoma, që është ba, nga familjarët dhe nga vetë misioni i OSBE-së. Në atë kohë ka qenë e pamundur ekipa hulumtuese e ekspertizës mjeko-ligjore të vijnë nga Tribulani i Hagës, që në atë kohë, ishte Luisa Arbur. Ata u kthyen në kufi me Maqedoninë, atëherë ne na

autorizuan pesë personave brenda në OSBE, të marrim përsipër dhe t'a hulumtojnë rastin. Dhe kam qenë e vetmja shqiptare që kam marrë pjesë, dhe sot është nënshkrimi im në raport mbi të cilin është ngritë aktpadia e Tribulanit e Hagës ndaj Millosheviçit. Poashtu, do të thotë kam marrë intervista të drejtëpërdrejta me refugjatë të cilët kanë qenë refugjatë shqiptarë, në Maqedoni personalisht kam marrë mbi 8000 intervista, intervista, të ngjarjeve të ndryshme, të cilat njerëzit i kanë përjetu.

Po ajo që mu më mbetet vragë në shpirt, sepse në tjerat i kemi punu kur jemi kthyer mbas luftës, për dy vite kam udhëheqë procesin e varrezave masive kudo në Kosovë. Personalisht kam marrë pjesë në hapjen e varreve, dhe nuk kam hezitu absolutisht për asnjë moment që të hyjë në varre, deri këtu {prekë gjoksin, tregon thellësinë e varrit} dhe të ballafaqohem drejtëpërdrejtë, me kufomat do të thotë, çfarëdo moshe, çfarëdo gjinie, sado që ka qenë e rëndë. Rasti ma i rëndë për mua është rasti i familjes Maçastena dhe Bogujevci, anës t'Podujevës-Llapit. Një familje e tan e ekzekutime, megjithatë masakër që është bërë ndaj popullatës shqiptare dhe ishte shumë vështirë, do të thotë kur ti e bën hapjen e varreve, edhe fillon identifikimin e pjesëtarëve të familjes Bogujevci dhe familjes Maçastena. Prej anëtarit më të ri të familjës, fëmijut një vjeç. Në momentin kur kam pas kontaktin e parë me kufomën e fëmijut një vjeç, normal që te ai fëmijë s'ke mujtë me gjet letërnjoftim, nuk ke mujtë me gjetë dokumente identifikuese, librezë apo pasaportë. Te ai fëmijë ke gjetë, vetura të vogla që i kish pas të futura në gji. Dhe kufoma e dytë e vazjës, shtatë vjeçe. Te ajo ke mundur të shohësh një barbikë, të cilën e kishte pasur me vete se ajo nuk ka ditur se çka është lufta. Kështu rradhazi tetëmbëdhjetë anëtarë të familjes Bogujevci dhe Maçastena, një mbas një, në fund do të thotë i identifikua dhe i'u bë rivarrimi i këtyre pjesëtarëve të familjes. Në fund mbetet një person i vetëm do të thotë, edhe pyetja e tij që mu m'u ka drejtu "Nazlie çka tash edhe kah tash?" Edhe janë momente që ti nuk ke, që ti nuk ke ngushëllim. Janë momente të cilat ti i sheh para varreve të pjesëtarëve të familjes më të ngushtë, më të shtrenjtë, të familjes që çmendemi ne për familjen, se jemi popull që jemi t'lidhun jashtëzakonisht shumë me familje dhe ti nuk ke shprehje dhe nuk ke ngushëllim, dhe ti nuk ke tjetër çka i thu.

Moment tjetër prekës për mua janë dhunimet e vajzave dhe grave të cilat janë ba në Kosovë, përjetime të cilat unë i kam në kujtimet e mia, i kam në trurin tim. Nuk e harroj kurrë asnjëherë, për asnjë moment, një vajzë trembëdhjetë vjeçe e anës së Suharekës e cila ishte dhunu në format orgji, do të thotë kanë ba orgji me atë vajzë. Edhe ku e kishim shatorin, ku unë punojsha, e kishim afër shatorit të asaj familjes, të Suharekës, një fshatit të rrethit të Suharekës. Nana e saj mu më ka vërejtë që po merrem me deklaratat, mirëpo ajo e ka pas presionin e vjehërrit të saj, që nuk ka gux me kërkë ndihmë, për arsye se ma i vjetri i shtëpisë e ka konsideru "marrja e shtëpisë" çka i ka ndodhë asaj vajzë trembëdhjetë vjeçe. Ai tu kërkë, do të thotë, prej djalit të vetë edhe nusës, për çdo natë me e vra, se kjo është "marrja e shtëpisë" kjo që ka ndodhë. Dhe ajo vajzë trembëdhjetë vjeçe kishte deviju, do të thotë psikikisht kishte deviju dhe nuk ishte në gjendje normale me moshataret e vetë. Nana e vetë ndërkohë më kontakton mua, dhe ma tregon komplet ngjarjen. Normal që unë atë ngjarje e marrë ndërmjet deklaratës, me Igon, dhe me aktivistet e tjera patëm kërkë prej Save dhe Children, Oxfam, dhe shumë organizmave të tjerë që të na mundësojnë që të kemi një tendë shumë të madhe, dhe t'i mbledhim të gjitha ato vajza, ku janë dhe ku s'janë në Qegran. Të krijojmë risocializimin e tyre, po me atë jetë refugjate, e cila ishte... isha refugjate edhe vetë, do të thotë nuk më bojke përshtypje pse punojsha për OSBE, po isha e barabartë, refugjate me të gjithë ata.

Dhe ndërkohë, mbas bisedës me nanën e kësaj vajze, m'bjen n'mend që është Igo t'u i organizu aktivitetet, risocializimin e vajzave ku kanë këndu, kanë brohorit... kanë dalë prej vetes, se kishim nevojë me dalë komplet prej vetes. Ndoshta, ai shtangimi i luftës, shtangimi jashtë shpijave tona, shtangimi i asaj se çka asht ka ndodhë, a do të kthehem i ndoj here, ose... Mos informacioni ku i kemi familjarët, nuk

kishim noj informacion se kush se ku ndodhet. E bisedoj me Igon, i them “Igo kshtu kshtu osht rasti i një vajzës trembëdhjetëvjeçe, nuk osht në gjendje normale, osht e dhunume; orgji kanë ba me to, mirëpo ekziston një tjetër presion familjar mbi atë vajzën.” Edhe Igo m’thotë “T’lutna Nazli e sjell, po t’litem mos m’trego, se nuk po du me ditë cila osht, se nuk muj me u përmbajtë ndaj rastit.” Edhe, do të thotë mbas një kohe të caktume, arrij atë vajzë trembëdhjetëvjeçe t’a tërhjekë prej tendës, me vullnetin e saj, jo diçka me dhunë. Shkojmë në tendë, dhe i shohim plot moshatare të saj t’u knu, t’u brohorit, t’u thonë vjersha... aktivitete të ndryshme. Zakonisht vajzat kanë knu me def, mirëpo, kur u ulshim me to, une e Igo e t’gjitha aktivistet barabartë me to... kishim nevojë, bukalisht kishim nevojë me këndu. Dhe vjen vajza ulet në mesin e vajzave t’jtera, do të thotë për herë të parë fillon me qeshë. Për herë të parë fillon mas dy muaj e sa, fillon me pas kontakt me botën e dytë, se çdo herë e mbyllun në tendë. Dhe është shumë çudi, është diçka rrëqethëse për mu, edhe sot kur e kujtoj! [Psherëtinë]

E përnihere e kërkon defin, e lyp defin me i ra deficit, edhe thotë “Teta Nazlie a t’knoj?” “Po, po moj zemër kno, qe edhe une po vij me ty me knu” Igo në t’tjetrën anë nuk i nalke lotët, e kthejke shpinën {kthen shpinën}. Edhe aktivistet e tjera që e dishin ndodhinë me atë vajzë, dhe kangën që ajo e ka knu, dy kangë “A vritet pafajësia” edhe “Oj Kosovë oj nana ime”. Edhe ajo non-stop ka këndu, e unë jom mundu n’forma t’ndryshme mos me m’pa ajo, se nuk kom mujtë me u përmbajtë, lotët s’kom mujtë me i nalë në asni moment. Këto jonë momente që për mu jonë noshta momentet ma t’vlefshme edhepse jonë të dhimbshme, që kom arritë një vajzë trembëdhjetëvjeçe t’a rikthej në mesin tonë, ku aty na kemi vepru si aktiviste. Kemi punu me organizma të ndryshme, mirëpo kemi arritë me sjellë një vajzë trembëdhjetëvjeçe me ulë me bashkëmoshataret e saj, përkundër presionit të familjes që osht konsideru ajo “marre e shpisë”. Për mu, për trembëdhjetë vite këto përjetime të grave m’kanë përcjellë, edhe ende m’përcjellin përderisa nuk ka drejtësi për to. Do të thotë rastet e dhunimeve jonë heshtë, edhepse konsiderohet që janë afër 22 mijë gra dhe vajza të cilat jonë dhunu nga paramilitarët, e ushtarët, e policia, civilët e krejt ato.

Mirëpo, të cilat i kemi mohu si viktimat t’luftës, përderisa dhunimi konsiderohet si instrument i luftës, edhe me Gjykatën e Krimeve të Romës edhe me Tribunalin e Hagës, edhe Konventa Ndërkombtare të ndryshme, konsiderohet dhunimi si instrument i luftës. Në anën tjetër e kemi mohu që ka ekzistuar për kto 22 mijë viktimat të dhunimeve në Kosovë, dhe këto 22 mijë viktimat jonë n’mesin tonë, ato bashkëjetojnë me ne; ndoshta i takojmë për çdo ditë edhe nuk e dijmë që jonë viktimat e ato jetojnë me ni padrejtësi shumë të madhe [qan]. Nëse e kemi arritë t’i rehabilitojmë të gjitha kategoritë e luftës, qofshin veteranë, qofshin familje të dëshmorëve, fmi të dëshmorëve, invalidë të luftës... T’gjitha kategoritë që lufta i konsideron me t’gjitha vlerat e saj që i ka, e kemi ba ni padrejtësi shumë t’madhe, shumë t’madhe që si shoqni nuk n’a falet asnihere. Do të thotë që kemi kriju padrejtësi, dhe ende jetojnë këto 22 mijë të dhunimeve me padrejtsinë ma t’madhe n’botë që ekziston [psherëtinë].

Zana Rudi: Çfarë storie më specifike kishe mujtë me veçu prej kohës para luftës dhe mbas luftës, ndoshta me spjegu ma ndryshe situatën, diçka për çka fole... prej anës tonde?

Nazlije Bala: Ngjarjet janë të ndryshme, prej momentit në moment. Secila prej tyre ka një karakteristikë të caktume. Natyra e vetë punës mrena në Këshill ka qenë natyrë që... shumë herë kemi qenë në rrezikë jete. E veçoj një rast në rrethin e Deçanit, saktë nuk e mbaj mend fshatin se a ka qenë fshati Shaptej, apo Baballoq, një vrasje që ka ndodhë prej kolonistëve serbë, ata ishin të ardhun prej Kninit, refugjatë të Kninit dhe të dislokum në Kosovë. Në atë kohë ndërtojshin shpia për refugjatët serbë nga vendet e

ndryshme. Ndodhë një vrasje në familjen Cacaj, po në atë vend. Si ekip me Këshillin kemi shku për evidentimin e rastit, fotografimin dhe të gjitha këto me kolegët.

Karakteristikë e saj nën një, do të thotë mu çka m'ka lanë mbresa... në atë kohë nuk ke pas mundësi të përafrohesh me traditën dhe kulturën e vendeve të ndryshme në Kosovë. Nën dy, forma dhe mënyra e vrasjes së atij djali, djalë i ri ka qenë. Dhe, nën tre ardhja e familjes së tij prej Zvicrrës e cila nuk ka qenë prezente. E katërta, atë natë kemi bujtë në Kullë, në pamundësi të kthimit prapa në Prishtinë për shkak të rrezikut e gjitha këto. Dhe dialogu, debati me plakën e atij vendi. Mbas të gjitha ekzaminimeve të cilat i bamë, ardhja dhe përgatitjes së kufomës, kontakti i parë i prindërve, sidomos i nanës me kufomën, edhe ajo mënyra e vajtimit, marrjes në përfaqim e kufomës, të gjitha. Tash vjen dilema se a duhet të besosh në ligjin e natyrës, apo një proces fizik të cilin organizmi e bën. Ne ishim afër kufomës, përnjëherë i kemi pa lotët kufomës. Përnjëherë e kemi pa rrjedhjen e lotëve të takimit apo ballafiqimit të nanës me djalin e ri, i cili ishte vra. E dyta, forma dhe mënyra e organizimit të burrave të cilët e largojshin prezencën e femrës për me qenë në atë kohë aty. Ndërkohë mua, si Nazlie nuk mundeshin me më largu, sepse unë isha në një mision të caktum, në një detyrë të caktume dhe në moment thonë {ngrit zërin} “O jo, jo, kjo është e jona, kjo nuk duhet me u largu prej këtuhit.” Dhe ty kjo të jepte përshtypje, vetë pozicioni yt ti ku ishe t'u punu të mundësojke me hy në ato vende, ndoshta që femrat nuk kanë qenë të lejume.

Në mbrëmje, masi që janë kry të gjitha ceremonitë, me plakën e atij vendit...se ishin kullat e mëdhaja, i them “hajde shkojmë brenda.” Hymë brenda dhe ajo tha “jo qika jem, ti e din këtë pjesë... burrat le të shkojnë në këtë pjesën tjetër” unë i them “jo, unë nuk mundem me u nda se më duhet me qenë me kolegë,” sepse ne kishim me e marrë ndonjë intervistë ende me e vazhdu procesin. Ajo po më thotë “A e din që kurrë këmbë femre nuk ka shkelë në odë?!” po e them kushtimisht të “Baballoqit”, tash nuk po e kujtoj saktë dhe po i them “qysh s'ka shkelë?” Tha “Kurrë, te na osht traditë që femra kurrë mos me hy në odë,” thashë “ka shkelë, s'ka shkelë, unë po hy brenda.” Kom hy brenda krejt burra e vetmja unë femër dhe në momentin e caktum kryeplaku i asaj shpie thotë “Thirreni plakën”... tash me më bë mua shoqëri plaka. Dhe bisedë pas bisede, po kthehem po i them plakës “Loke fol diçka, një llaf, një muhabet” qysh e don tradita dhe zakoni. Nuk i harroj fjalët e asaj plake, që sot për mua janë mësim dhe kudo që shkoj e them, e flas. Ajo më thotë “A... çka kom me thanë une? Kur kam qenë e vogël m'kanë thanë ‘shuj’. Në kohën kur jam rritë pak ma shumë, kur kam hy në bylyk, ‘shuj se ti marre është me folë’, kur jam martu, ‘ti grua e fisit nuk ban me folë’, kur jom plakë ‘shuj se ti s'din kurgjo je budallë’”. Ajo e përshkruan një proces çdo herë të heshtjes në pamundësi me ofru diçka më shumë.

Element tjetër çka e veçoj, se jeta është zakonisht veç kujtime, janë vrasjet në Qerez dhe Likoshan, sidomos vrasja te familja Ahmeti. Është një kronologji, një ngjarje që vërtetë të rrënoqethë kur e ndëgjon, jo ta filmosh, t'a argumentosh në mënyra të ndryshme: dhunimet që kishin ndodhë te gratë dhe vajzat, që kishin ndodhë në familjen Ahmeti, dhe rezistenca e familjes Ahmeti që mos me u shkru absolutisht kërkund që vërtetë ka ndodhë dhunimi. E pranojshin vrasjen si vrasje, vrasjen makabër mbi njëzet anëtarë të familjes që i kishin masa kru në oborrin e tyne, dhe e rezistojshin pranimin e asaj që ishte pjesë e luftës faktikisht me e mohu ndodhinë që kishte ndodhë ndaj vajzave, grave. Insistimi ynë i vazhdueshëm ishte që ajo të jetë pjesë e deklaratave dhe të jetë pjesë e ni historie, se dhunimi duhet të evidentohet, dhunimi duhet të shkruhet.

Veçori tjetër është takimi im i parë me dy vajzat e komandantit legjendar Adem Jasharit, ka qenë në vitin '97... sulmi i parë në familjen e Jasharajve kur ka ndodhë në Janar të 97-tës, këto dy vajzat kanë qenë të plagosura. Nuk e harroj asnjëherë kontakti i parë që e kam pa Adem Jasharin gjallë, i cili edhe në kullë, na

vizitoi, na uroi punë të mbarë. Forma dhe mënyra e bisedës me to, kontakti i parë ballë për ballë me Hamzën, me Shabanin dhe me pjesëtarë tjerë të familjes; t'u mos e ditë asnjëherë që ma vonë kjo familje kanë me qenë udhërrëfyes të lirisë, të çlirimit të Kosovës dhe pikënisje me emër të kësaj familjes. Veçori tjetër e karakterizoj në Janar të '98 vrasja komplet e familjes Jashari, jo të Janarit por të Marsit 5, 6 dhe 7 Marsit. Hera e dytë që shkoj në atë familje dhe evidentimin e kufomave, fotografimin e kufomave dhe mënyrën përpilimit të rastit, si rast që ka ndodhë. Po ato dy vajza i shoh të vrame në mesin e të vramëve, po atë legjendar me familjen e tij i shohë të vramë në mesin e të vramëve.

Karakteristikë tjetër është edhe rasti i Reçakut “Lufta për kufoma” e cila ka qenë në atë kohë, jo rasti si rast për Reçak. Dihet që Reçaku ka ba kthesa të mëdhaja, por lufta një mujore e cila është zhvillu në mes forcave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave të Serbisë për kufoma. Faktikisht kufomat ishin peng të forcave të Serbisë. Nuk e lejojshin as varrimin, as obduksionin mjekësor, dhe të gjitha ato peripeti, e di, që ka zgjatë mbi një muaj kjo peripeti. Janë kujtime të ndryshme brenda përbrenda këtij elementi. Krahas punës si aktiviste e Këshilit po në t'njëjtën kohë, i maj n'mend sikur sot qenë një grup jo shumë i madh, një grup kemi qenë shumë i vogël i grave që kemi organizu marshe, dhe protesta të ndryshme në Kosovë. Them marshe dhe protesta që kanë ditë vërtetë t'a tronditin botën, t'a shkundin botën. Kemi arritë mbi treqind mijë gra t'i mbledhim në Prishtinë dhe të organizojmë “Marsh për Drenicën”. Kuptohet, ky marsh nuk e ka arritë cakun e vet që të shkojë vërtet në Drenicë se u ndalëm në rrugë. Por ka arritë t'a ngrehë zërin, jo ta vetëdijësojë, por vërtetë t'a ngritë nga gjumi bashkësinë ndërkombëtare mbi vrasjet dhe masakrat të cilat ndodheshin në atë kohë në Kosovë.

Pra kronologji e shumë ngjarjeve që janë me mu si pjesë e çdo momentit kudo që shkoj, kudo që shkoj sot në terren, kur të udhëtoj nuk ka fshat, nuk ka qytet me të cilin nuk me lidhë një ngjarje. Sado që janë kujtime, janë edhe memorie të asaj por për mu janë të hidhura. E di që shoh persona në ato vende ku unë kam qenë, në ato vende ku unë kam vepru, nuk janë në mesin tonë apo nuk janë në mesin e të gjallëve. Është kujtim thuajse në çdo trevë dhe në çdo pjesë kudo që unë kam vepru dhe kudo që kam shkelë.

Zana Rudi: Nazlie, cilat kanë qenë andrrat e tua në atë kohë, cili ka qenë vizioni yt në atë kohë, dhe a mundesh me m'tregu nëse diçka prej asaj është realizu dhe çka është arritë?

Nazlije Bala: Vizioni ka qenë gjeneratë mbas gjenerate edhe ka qenë një ideal i cili na ka përcjellë kudo që na kemi qenë, qoftë si fëmijë, qoftë në moshë pak ma të rritun apo drejtëpërdrejtë ke qenë e kyçur në procese. Vizion dhe ideal të cilin të gjithë e kemi pas... çlirimin e Kosovës, me marrë frymë lirshëm, lirinë e plotë, zhvillim të vendit të gjitha këto ideale për çka edhe janë sakrifiku njerëzit. Ndoshta për një flamur njëri ka hangrë njëzet deri në tridhjetë vite burg. Po e ndërldhi vizionin me idealin dhe me atë sot se ku jemi, nëse ke vepru me qenë i lirshëm dhe vendi yt me u zhvillu në atë formën dhe mënyrën t'cilën... të gjithë andrra kemi pas. Po e ndërldhi me momentet aktuale, me kohën të cilin sot e jetojmë, më duket që kemi deviju nga vizioni dhe kemi deviju nga ideali. Nuk gjinden askund ata parametra apo ajo kornizë që secili në kokat e tona i kemi pas.

Nuk du t'tingëlloj radikale, nuk jam shpirtërisht radikale, mirëpo vetëm kur i mendoj momentet që shumë herë më ka rasis të jem kur është bërë betimi i ushtarit të UÇK-së... “Do të luftoj për këtë vend, për këtë flamur,” dhe prapë kthehem në prapavijë, kthehem në skenë, ku është ai betim i ushtarit për të cilin ka sakrifiku, apo është betu që do ta jep jetën? A thu kemi mundu që trembëdhjetë vite pas luftës... vërtetë atë vizionin e krejt atyne njerëzve të cilët e kanë idealizu lirinë si liri, dhe të drejtën si të drejtë, e kemi arritë që së paku t'i vnojmë në praktikë?

Mendoj që jemi shumë larg vizionit, shumë larg idealit, jetojmë në një politikë *ad-hoc*, e cila nuk ofron absolutisht përmasa të një vizionit, nuk ofron përmasa të një idealit sepse për të qenë atdhetar, vizionar dhe për të qenë idealist, duhet të kesh diçka brenda për brenda zemrës tënde që flen apo atij koncepti të përgjithshëm të shtetit si shtet. Nuk di, nuk kam pa dhe ende nuk i kam përjetu ato të mirat e shtetit, burimet e shtetit, atë zhvillim të shtetit, atë kornizë për të cilën është ba gjithë ajo luftë, është derdhë i gjithë ai gjak. Nuk do të doja të hyjë në detaje se, pse nuk e kam atë vizion, dhe nuk do të doja që të tingëlloj pesimiste në atë vizion për arsye se të gjithë ne mund të ndryshojmë shumë. Të gjithë ne mundemi jo në mënyrë të lehtë por nëse ulemi dhe vërtetë mendojmë dhe vërtetë i'a duam të mirën këtij vendi, këtij kombi, këtyre qytetarëve, për nder të gjithë atyre për të cilët kanë dhënë jetën për shtet dhe për liri duhet të ndryshojnë në vetvete për t'i ndryshu të tjerët.

Nëse nuk e krijum atë koncept, atë vizion tamam si duhet në kokat tona, kam frikë që kanë me na përcjellë për vite të tëra dhe do ta humbim atë konceptin se qysh duhet të krijohet një vizion, se qysh duhet të krijohet një shtet. Ka shumë situata të cilat vërtetë më demoralizojnë, nuk është e thënë që duhet të hysh në politikë, të merresh me politikë, unë mendoj që çdo hap i yni është politikë ditore kudo që veprojmë. Kur e shohim realitetin prej andrrës që e kemi pas, mendoj që jemi shumë larg prej realitetit. Nëse Kosovën e kemi andërru po e them kushtimisht, një "Zvicër të dytë"... Ne e dijme se çka është Zvicrra, e dijme zhvillimin e saj, i dijme kapacitetet e saj, atëherë ku është ajo Kosovë të cilën une e kom andërru? Nëse e kemi andërru Kosovën si një shtet me resurset më të mëdhaja, apo me burimet më të mëdhaja të pasurive natyrore, dhe cilat janë të mirat e asaj pasurie natyrore të cilat sjellin zhvillim dhe progres në vend. Sot ballafaqohemi me 45 përqind të papunësisë në vend, në mesin e tyre mbi 60 përqind janë moshë rinore, një armatë e tanë. Ku është ai zhvillim dhe ku janë ato burime për të cilat unë kam andërru dhe për të cilat prapë jam në gjendje t'sakrifikoj, t'rifilloj edhe njëherë prej hapit të parë, nëse Kosovën e kemi andërru si vend i mundësive të barabarta për të gjithë. Të gjithë ne në forma dhe mënyra të ndryshme e kemi përjetu diskriminim, apartheidin, segregacionin edhe shkeljen më të vrazhët të të drejtave të njeriut. A jemi na po ata të njejtit njerëz të cilët kemi luftu, dhe kemi qenë kundër por pasojat të cilat po i bartim mbi supet tona, dhe po e lejojmë diçka e tillë e pashkrume të ndodhë në Kosovë. Nuk po e them që ka segregacion apo apartheid në Kosovë, por ka shkelje jashtëzakonisht të madhe në të drejtat e njeriut. Është mohu një vlerë shumë e madhe e shoqërisë. Në skenë kemi antivlerat të cilat e udhëheqin shtetin, por besoj jashtëzakonisht shumë që vërtetë këtyre antivlerave një ditë do t'iu vjen fundi, dhe do të dalin në hapësirë, në pah, të vnohen në kornizë andërrat e kësaj rinie aty ku ka progres, aty ku ka zhvillim, që secili do ta ndërtoj jetën në formën, dhe mënyrën të cilën e dijnë.

Zana Rudi: Po e di që ke shumë me tregu, nese mund të na shpjegosh dicka me storie nga ana personale?

Nazlije Bala: Po du me të kallxu një detaj. Mbas luftës, më duket e kemi tregu kur kemi kërku me lgon me u shpallë "Heroina"... gratë e dhunume, takimet që i kemi pas me kryeministrin aktual të Kosovës. Trembëdhjetë vjet pas asaj, tash kur kërkon ti drejtësi për padrejtësinë më të madhe që të është ba, edhe prej nri rrethit shumë të ngushtë jemi "viktima të dhunimeve," kjo të brenë. Nëse ti ke mendu për invalidë të luftës, i ke rehatu me ligj ato janë viktima civile të luftës. Familjet e dëshmorëve i ke rehatu përmes ligjit janë viktima civile, pavarësisht asaj janë viktima civile. A thu këto njëzet mijë viktima prej çkafit janë? Viktima të kujt janë? Ne e dijme që janë viktima të luftës por ti si shtet sa ke mujtë me i vnu në kornizat e tua? Nëse ti ke ndëgju për lufta të ndryshme, sidomos po flas për luftën në Bosnje, kemi pas kontakte të drejtëpërdrejta, takime dhe jemi ballafaqu me vetë viktimat, jemi në debate dhe në diskutime. Kur e krahason, na e kemi pas të njejtin agresor, të njejtin pushtues, me të njejtin person kemi ba luftë, edhe

Bosnja, edhe Kosova, edhe Kroacia. Janë përdorë të njejtat metoda të luftës, absolutisht nuk kemi pas asnjë ndryshim prej metodave dhe formave dhe mënyrave të luftës. Dhunime kanë ndodhë atje, dhunime kanë ndodhë në Kosovë, masakër atje, masakra atje, masakër në Kosovë. Më duket i njëjti skenar, nuk ka mujtë kërkush me i ikë skenarit të Serbisë.

Kthehesh trembëdhjetë vite mbrapa, ende e kërkon drejtësinë padrejtësinë më të madhe që të është ba, për të gjitha gratë e dhunime gjatë luftës. Trembëdhjetë vite ti kërkon drejtësi për atë që ti ta trajtosh barabartë në shoqëri. Trembëdhjetë vite nuk janë pak, dhe trembëdhjetë vite mundohesh në forma dhe mënyra të ndryshme që ta gjesh brenda institucioneve që ti e ke ëndërru gjithmonë, që një ditë ke me e pas parlamentin tënd, qeverinë tënde, ushtrinë tënde, policinë tënde, ligjet tua, gjykatën tënde, prokurorinë tënde dhe të punosh në aspektin e drejtë legal. Kemi vujtë dhe me pasoja shumë të mëdhaja, dhe padrejtësitë e mëdhaja që na u kanë bërë si popull, si vend. Tash kthehesh në anën tjetër dhe kërkon diçka që është vlerë të cilën duhet t'a ruajmë se është një kujtesë kolektive, të cilën nuk guxojmë asnjë prej neve me ra në harresë kolektive. Si shoqëri nuk guxojmë me i harru këto gjana. Karakteristikë tjetër çka mua më bënë përshtypje, sepse e kam atë mllëfin brenda për brenda vetit, se qysh ne nuk ditëm dhe nuk arritëm askund që ta krijojmë një simbol të gruas në Kosovë, por qofshin edhe dy shkrojna të qitura dikund në muri.

Kur e kujtoj ajo çka ka ba, roli i saj ka qenë i dyfishtë për tan krejt këtë periudhë që na e kemi kalu, si dhe për periudha të më hershme. Askund nuk kemi një simbol të gruas, të sakrificës së saj, idealit të saj, që ajo ka ba për këtë vend dhe kjo më ban që vërtetë t'a kem atë mllëfin. Jo që t'i urrej institucionet, absolutisht jo sepse institucioni është një objekt, një ndërtesë, jo ti urrej njerëzit, por t'a kritikoj politikën e tyre, çasjen negative që e kanë ndaj ksaj kërkese që na si gra aktiviste, që asnjëherë nuk ndalemi me kërk. Shumë herë ndodh që vërtetë të kem mllëf me vetvetën, "A thua për çka kam punu, për gjithë këto vite?" Nuk janë pak, janë njëzet e tri vite. Unë e ndërliha automatikisht periudhën e mbas luftës, ku ndërtojmë institucione, ndërtojmë sistem të drejtësisë, edhe asnjëherë nuk muj me u pajtu që aq shumë egzistojnë dhe ka padrejtësi të mëdha në Kosovën tonë të mbas luftës, të cilën e kemi ëndërru dhe ku vërtetë andërrat tona do të bëhen realitet. Nuk muj me e besu dhe për mu është e pakapshme se ne nëse kemi ditë të organizohemi si shoqëri në aspektin e solidaritetit, me i ndihmu familja familjes, unë sot rrënoqthem kur shohë skena në televizion të emisionit "Edhe unë jam Kosovë".

Nuk muj me besu që skamja edhe varfënia ka ardhë deri në atë shkallë sa që institucionet, shteti, individët brenda në institucione të mos i'u bëjë përshtypje apo të mos i'u lë ndonjë mbresë. Nuk e di a e ndjejnë obligime dhe a ndjejnë përgjegjësi ndaj atyne njerëzve që vërtetë kanë ngritë ideale dhe andërra. Nuk muj me e besu, dhe nuk pajtohem asnjëherë kur shohë radhë të ndryshme brenda përbrenda institucionit për të cilat ti ke punu dhe ke sakrifiku. Mua më ka ndodhë shumë herë që të hyjë brenda në Komunë, dhe puna si punë të të mos kryhet asnjherë, të hy brenda një Ministrie, të ballafaqohesh më miliona hierarki dhe byrokraci për shërbimet të cilat shteti si shtet është i thirrur t'iu ofrojë qytetarëve. Nuk muj me e besu që këto institucione ku ne pretendojmë që duhet të jenë ma të forta sepse aty rrjedhë çdo gjë... duhet që të krijojmë presione të ndryshme prej shoqënisë që shteti duhet të mendojë për kategori të caktume të shoqërisë, edhe për nëna vetëushqyese që për mua është një brengë jashtëzakonisht e madhe që nuk kanë të drejtë asistence sociale, nuk kanë të drejtë të shfrytëzimit të të mirave të shtetit.

Është problem edhe gjenerata e të moshuarëve, unë takoj të moshuar thujse çdo ditë, vetë kom të moshum në familje. Kom prindin brenda familjes i cili për dyzet e sa vite ka ofru shërbimet e veta si

kryetëknik, apo në aspektin medicinal i cili ka kryer shërbimet e veta thuhetse 24 orë. Atë prind e kemi secili dhe ai prind të mos e gzojë epitetin e një personi tamam qysh i ka hije, sepse katërdhjetë e sa vite punë, nuk janë vite të cilat hudhen aq lehtë. Ka lloj-lloj situata në të cilat në ndihem e mllëfosun, prapë po them jo radikale në vetëveten, por e mllëfosur. Kudo në botë shënohen data të caktume në kujtim të të zhdukurve, vetëm në Kosovë nuk e kemi ndonjë datë të caktume ku do të ulemi dhe do t'i kujtojmë ata të cilët nuk janë në mesin ton, nuk dijmë absolutisht ku ndodhen, se a janë të vramë apo nuk janë të vramë, dhe nëse janë të vramë, ku janë të varrosur? Kjo është me të lanë pa koment, pa tekst. A thu se për çka funksionojnë ato institucione?

Një element tjetër për të cilin nuk i'a lë fajin vetëm institucionit, ku para disa dite përpara parlamentit është organizu protesta "Për të Zhdukurit" dhe ne e dijmë numrin e saktë të këtyre të zhdukurve, dhe, për habi dhe çudi një numër shumë i vogël merrë pjesë në këtë protestë për adresimin e një çështje të caktume për të zhdukurit. Si dhe pjesa tjetër e kalimtarëve të cilët vetëm e kthejnë kokën, dhe absolutisht pa ndonjë reagim të veçantë se për çka po protestohet se ku është poenta e protestës dhe për çka po adresohet. Jemi zhveshë komplet prej asaj qenies, ku kemi qenë ma herët, prej afërsisë si njerëz dhe prej solidaritetit si njerëz, prej mos durimit të shkeljes së përditshme të jetës të qytetarëve në forma dhe mënyra të ndryshme. Ajo na mungon, e vërej që më mungon edhe mua si Nazlie, për arsye se gjej shumë herë pesimizëm tek njerëzit edhe pse mundohem që të i'u ofroj sado kudo kurajo që ne jemi ata që duhet të bëjmë ndryshime, ne jemi ata që duhet të marrim iniciativa që të hudhim ide, të lëvizim sende prej vendit. Mirëpo, është instalu një mentalitet që hajt se ka kush mendon për neve, dhe unë po rri indiferent ndaj asaj që po ndodhë komplet përreth neve. Si pjesë e barabartë e shoqërisë, e vërej që mungon ajo pjesë që të vnoj mekanizma, të vnoj binarë, apo t'i ndezi ato turbinat që mos të ndalem asnjëherë. Dhe, s'do të ndalem asnjëherë qysh thojnë "nuk do të lë gurë pa rrotullu" dhe nuk do të lë formë dhe mënyrë pa e provu... që vërtetë ta ngrisim këtë vetëdije dhe ta lëmë mbrapa këtë mentalitet "se ka kush punon për mua dhe unë nuk do të punoj" duhet të ecim në menyrë të barabartë.

Ajo çka është më e dhimbëshme nuk po du me e lavdëru vetëveten absolutisht, por po e vërej që po i'u mungoj institucioneve shumë. Unë e vërej që mu më mungon institucioni shumë se e di çka kërkohet dhe e di çka punohet. Kam konkurru në shumë vende të punës, vende kyçe, por përgjigja që kanë... këtë po e them publikisht, kam ardhë deri te intervista në mesin më të ngushtë pa intervenca, pa të gjitha ato, në punën që unë e punoj. Dhe, anomalia më e madhe e përgjegjës që unë e marr është "Nazlie po na vjen shumë keq, ne e dijmë se kush je ti, e dijmë se qysh punon, e dijmë kapacitetin, vullnetin e energjinë, e krejt ato, por është një njeri i partisë dhe nuk kemi qare pa e shti mrena" atëherë ti ndalesh, mendon. Ne e dijmë që partitë vijnë në skenë, ne e dijmë që partitë e krijojnë pushtetin, ne e dijmë që partitë e udheheqin institucionin, por a guxojmë t'i lëmë këto institucione në dorë të atyre që nuk kanë përvojë, nuk kanë vizion, nuk kanë qasje serioze ndaj problemeve të përditshme të shoqërisë, dhe a guxojmë që vërtetë institucionet t'i lojmë në durtë e militantëve të partisë? Kemi pasqyrë shumë të qartë, për trembëdhjetë vite që institucionet tona janë udheheqë nga militantë të partisë. Kemi një shembull shumë të mirë, një *case study*, është një rast për studim, që partinë njerëzit e konsiderojnë si një vend pune, dhe jo si një vend ku ti krijon ndryshimet në shoqëri dhe i ofron të mira materiale asaj shoqërie.

Por sa e sa njeri është në pozitën time apo në mendimet e mia që të njëjtat rrethana dhe situata i kanë ballafaqu me miliona herë... dhe po jemi po prapë të njëjtit njerëz që prapë nuk po zbrapsemi. Nuk po hezitujmë të ndryshojmë këtë formë, këtë mënyrë të të jetumit në Kosovë... që të mendohet një herë e përgjithmonë që kushdo që shërben në këtë vend duhet të shërbejë aty ku duhet, ku e ka vendin, e jo për vetëveten dhe jo për një rreth të caktum të njerëzve. Nuk e kemi andërru dhe nuk e kemi kriju atë vizion

që institucionet duhet t'i shërbejnë vetëm një rrethi të caktum të njerëzve, dhe kjo është ka ndodhë në Kosovë. Është jashtëzakonisht dëshpëruese, shumë herë më ka dëshpëru apo më ka rrëzu për toke, se unë nuk e kam pas një ëndërr të tillë. Nëse hyjmë në elemente shumë më të thella brenda përbrenda familjes, është një institucion në vete dhe shteti është ai i cili drejtëpërdrejtë ka lidhje diagonale me familjen. Dhe te ne për fat të keq familja nuk preket, nuk preket si institucion në veti, se cilat janë kërkesat e asaj familje, se cilat janë metodat e asaj familje, cilat janë nevojat e asaj familje? A ka nevojë për shëndetësi më të mirë? A ka nevojë për edukim më të mirë? A ka nevojë për zhvillim më të mirë? A ka nevojë për arsimim më të mirë? A ka nevojë për mirëqenie më të mirë brenda përbrenda familjes? Dhe, kjo është ajo diagonalja e shtetit që unë personalisht si Nazlie, hala nuk e kom ndi, nuk e kom ndi atë prekjen e shtetit si shtet kur të prekë dikush dhe të len një lloj gjurme të prekjes si individ në trupin tënd. Kur e them si Nazlie unë jetoj dhe hala nuk e kom ndi në brendi teme, dorën e shtetit që unë jam e mbrojtun prej shtetit. Unë jam e garantume prej shtetit në të gjitha format të cilat i ceka më herët si në shëndet, arsim, edukim, emancipim, progres, ekonomi, mirëqenie të përgjithshme. Unë po flas si individ... Por, ku është pjesa tjetër e shoqërisë? Dhe sa përkon kjo andërr e jemja me atë të para luftës, dhe më këtë që e ballafaqoj tash pas luftës. Larg çdo realiteti në Kosovë..